



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 29/2020 regjistër (JR)
Datë 16.07.2020

Nr. 34 i vendimit
Datë 21.09.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike më datë 21.09.2022, ditën e mërkurë, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Fabiola Dardha, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj, gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 245, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.2018”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksiononin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh dhe në vijim në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim, në parashtrimet para dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili

kërkoj përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 245, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të tij, dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me ndryshimet kushtetuese me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, mbante detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe, për shkak të këtij funksioni, në zbatim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Për subjektin e rivlerësimit Ardit Mustafaj, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) është kryer hetimi administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ¹ (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
- *Ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë.*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurie.*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport të arsyetuar² pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ardit Mustafaj.

2.3 Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit

¹ Lidhur me raportet e organeve ndihmëse, si DSIK-ja dhe KLGj-ja, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, paragrafi 19, shprehet se:

“[...] ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.

iii. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (tashmë Gjyqësor) është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, të deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 31.07.2019.

një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 245, datë 05.03.2020, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar [...].*
4. Në përfundim të procesit, Komisioni ka arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, por nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për arsye se:
 - a) ***Për pasurinë e identifikuar me nr. 1**, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të huas së marrë në shumën 2.000.000 lekë, shtetasit A. M., burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 850.000 lekë, krijuar nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore nga bashkëshortja e subjektit, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto të ardhura të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie, si dhe bazuar në analizën financiare, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave, në shumën 2.700.033 lekë, në vitin 2004, për të investuar në këtë pasuri të paluajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.*
 - b) ***Për ndërtimin e objektit 1+1 në Sarandë, në vitin 2003**, bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave në shumën 6.686.074 lekë, për të kryer të gjitha investimet gjatë vitit 1996 deri në vitin 2003, për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion justifikues vlerën e shpenzuar për ndërtimin e objektit dhe, për pasojë, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e kësaj pasurie, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
 - c) ***Për pasurinë e identifikuar me nr. 4 (apartament në Sarandë)**, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të shumës 1.700.000 lekë, marrë hua nga shtetasi Gj. D., sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare për vitin 2003, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar pagesën e shumës 22.000 USD për këtë pasuri në vitin 2003, deklaruar në deklaratën “vetting”.*
 - ç) ***Për pasurinë e identifikuar me nr. 5 (autoveturë)**, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave, në shumën 2.700.033 lekë në vitin 2004, për të investuar në këtë pasuri të luajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.*

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 245, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit për shkaqe të lidhura me procesin e rregullt ligjor, aspektet procedurale e të zbatimit të ligjit material, si dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin për faktet e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me objektin 1+1 kate në Sarandë, për kohën dhe kostot e ndërtimit të tij dhe vlerësimin e burimeve të financimit, duke kundërshtuar

³Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.09.2019.

në këtë mënyrë analizën financiare të Komisionit për personat e tjerë të lidhur për vitet 2002-2003.

6. Subjekti i rivlerësimit, me ankimin, paraqiti disa akte për të cilat kërkoi nga Kolegji marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - i. Gjykimin e çështjes në apel në seancë gjyqësore, në prani të palëve, për shkak se vendimi i ankuar është bazuar në shkëlqe të rënda procedurale e kushtetuese, si dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht, në mënyrë jo të plotë dhe jo të saktë, prandaj është i nevojshëm të përsëritet shqyrtimi i provave të dosjes se rivlerësimit, si dhe të lejohet paraqitja e shqyrtimi i disa provave të reja, për të cilat plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.
 - ii. Marrjen e provave të reja në gjykimin e çështjes në apel, të cilat janë cituar shprehimisht në përmbajtjen e ankimit.
 - iii. Prishjen ose ndryshimin e vendimit nr. 245, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, të vendoset konfirmimi i subjektit në detyrë.

A. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

7. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe janë si më poshtë vijnë.

7.1. Lidhur me pasurinë objekt 1+1 kate në Sarandë, me sipërfaqe trualli 304 m², të shitur në vitin 2004, subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit lidhur me shpenzimet e ndërtimit në vitin 2003, të cilat janë më të larta se shuma e deklaruar prej tij në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, janë kryer mbi përlogaritje jo të drejta dhe, si të tilla, ato kanë ndikuar negativisht në analizën financiare të këtij viti. Gjithashtu konsideron të padrejtë edhe mospërfshirjen në analizën financiare të vitit 2004, vlerën e përfituar nga shitja e këtij objekti.

7.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me burimin e ligjshëm të huave të marra nga personi tjetër i lidhur, shtetasi A. M. (vëllai i bashkëshortes) në vitet 2003-2004, në shumën 2.000.000 lekë, pjesërisht e përdorur si burim krijimi për ndërtimin e objektit 1+1 kate në Sarandë (1.000.000 lekë) dhe pjesërisht për blerjen e apartamentit në Tiranë (1.000.000 lekë), (e kthyer plotësisht) duke pretenduar se shumata e dhëna hua, janë krijuar prej huadhënësit me burime të ligjshme.

7.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me burimin e ligjshëm të huas së marrë nga personi tjetër i lidhur, z. Gj. D., në vitet 2002-2003, në shumën 1.700.000 lekë, të përdorur pjesërisht si burim krijimi për ndërtimin e objektit 1+1 kate në Sarandë si dhe për blerjen e apartamentit me sip. 54 m² në Sarandë, duke pretenduar se shuma e marrë hua nga ky huadhënës, është krijuar prej tij me burime të ligjshme, të rrjedhura prej të ardhurave nga aktiviteti tregtar që ai ushtronte në atë kohë, si dhe nga paga e përfituar, për të cilat ai ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit të kohës.

7.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si tërësisht të pabazuara konkluzionet e Komisionit lidhur me qëndrimin, sipas të cilit subjekti nuk arriti të provojë bindshëm dhe me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave, në shumën 850.000 lekë, të krijuar nga bashkëshortja e subjektit prej mësimdhënies së kurseve jashtëshkollore dhe se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto të ardhura.

7.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit se për shumat e dhuruara bashkëshortes (200.000 dhrahmi greke dhe 1.898 US\$) nga familjarët, aftësia financiare për t'i krijuar dhe ligjshmëria e tyre mbeten në nivel deklarativ, duke e konsideruar atë një konkluzion të pabazuar.

B. Shkaqet e ankimit, lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material

8. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe janë si më poshtë vijojnë.

8.1. *Subjekti në ankim ngre pretendime për shkelje të KPK-së që kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6/1 të Konventës së KEDNj-së, kanë të bëjnë me paanshmërinë e trupës gjyqësore të Komisionit.*

8.2. *Subjekti i rivlerësimit pretendon për mungesën e mjeteve efektive për të realizuar të drejtat e garantuara nga KEDNj-ja, si e drejta për të pasur akses në gjykatë, cenimin e parimit të barazisë së armëve, të sigurisë juridike si pjesë e parimit për një "gjykim të drejtë".*

8.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon për cenimin e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 8 të KEDNj-së.

8.4. Subjekti pretendon se çështja e tij duhet gjykuar në Kolegj në seancë gjyqësore publike, pasi duhet vlerësuar e konsideruar se:

- i. Në kundërshtim me procedurat e aplikuara nga Komisioni, subjekti, deri në momentin e zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk ka mundur të njihet me përmbajtjen e fashikullit të hetimit administrativ, gjë e cila, sipas subjektit, ka cenuar të drejtën e tij për t'u mbrojtur.
- ii. Analiza financiare e dhënë në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, paraqet një situatë financiare edhe më të rënduar nga analiza financiare e paraqitur në raportin e hetimit paraprak dhe për të cilën, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ky organ i ka kaluar subjektit barrën e provës.
- iii. Komisioni ka gabuar duke konsideruar si të përfunduar objektin 1+1 kate në Sarandë, i cili, në deklaratimet periodike të subjektit, por edhe në fotot e paraqitura si provë prej tij, rezulton se ka qenë në fazën e ndërtimit karabina në momentin e shitjes, situatë e cila bën të domosdoshme, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, nevojën për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj.
- iv. Procesi i rivlerësimit nuk është një proces i mirëfilltë disiplinor, pasi sanksionet që aplikohen u ngjasojnë dënimeve plotësuese penale, madje janë më të ashpra pasi kanë afate zbatimi më të gjata, ndaj subjekti pretendon se i duhet dhënë mundësia e plotë që çështja e tij të dëgjohet në seancë gjyqësore publike dhe të gjitha provat të shqyrtohen.
- v. Meqenëse Komisioni është organ administrativ, atëherë Kolegji, kur i kërkohet nga subjekti, duhet të funksionojë edhe si gjykatë fakti për të vërtetuar fakte dhe për të pranuar prova dhe nuk duhet të zbatojë formalisht rregullat procedurale të gjykatës administrative të shkallës së dytë.
- vi. Nisur nga fakti se Kolegji duhet të korrigojë çdo mangësi procedurale në gjykimin e Komisionit, në rastin objekt shqyrtimi duhet që gjykimi i çështjes të bëhet në seancë gjyqësore publike pasi seanca dëgjimore e zhvilluar në Komision, ka qenë krejt formale pasi vetëm përgjatë seancës, subjektit iu bënë të njohura rezultatet e hetimit, si dhe u konstatua se nuk ishin vlerësuar provat e reja të përcjella nga subjekti.

vii. Kolegji nuk është thjesht gjykatë apeli, por edhe Gjykatë Kushtetuese dhe, si e tillë, duhet t'u përgjigjet pretendimeve dhe kërkesave të subjektit të rivlerësimit për një mbrojtje efektive, duke shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore publike.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, z. Ardit Mustafaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ka paraqitur ankim në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. nr. 245, datë 05.03.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

12. Kolegji, më datë 13.07.2022, gjatë shqyrtimit të çështjes mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi, bazuar në ankimin e subjektit të rivlerësimit Ardit Mustafaj, si dhe mbështetur në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit, pasi çmoi se debati gjyqësor ishte i nevojshëm për korrigjimin e shkeljeve procedurale të kryera nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe konstatimin e drejtë të situatës faktike, duke kërkuar prej Komisionit përcjelljen e çdo akti që kishte administruar gjatë hetimit administrativ dhe që nuk ishte pjesë e fashikullit të depozituar në Kolegji sipas inventarit që e shoqëron atë.

12.1. Ky vendim i Kolegjit u mor pasi u konstatua se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ishte njohur me aktet e hetimit administrativ para seancës dëgjimore (nga aktet rezultonte se subjekti nuk kishte marrë kopje shkresore apo elektronike të akteve të hetimit administrativ) dhe, për më tepër, nga aktet që i ishin

bashkëlidhur ankimit, rezultonte se ai, pasi i janë komunikuar rezultatet paraprake të hetimit, për disa ditë ka qenë i pajisur me raport mjekësor⁴ të paaftësisë në punë.

- Në fashikullin e hetimit administrativ rezultonte se mungonin akte të cilat subjekti në ankim, por edhe në parashtrime, si dhe në korrespondencën me Kolegjin, referonte se i kishte paraqitur në cilësinë e provës përgjatë hetimit administrativ, duke e faktuar këtë pretendim me kopje të korrespondencës elektronike me Komisionin.
- Rezultatet e analizës financiare të vendimit të Komisionit kishin konkluduar për një rezultat negativ të situatës financiare të subjektit, e cila për një vlerë të konsiderueshme dukshëm rezultonte e përkeqësuar në raport me analizën financiare që Komisioni kishte njohur dhe i kishte kaluar subjektit barrën e provës në raportin e hetimeve paraprake.

13. Gjatë gjykimit në seancë gjyqësore publike, lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore që subjekti i kishte bashkëlidhur ankimit, analiza për pranueshmërinë e tyre si prova të reja në gjykimin e çështjes, u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të së cilës Kolegji vendosi të marrë me cilësinë e provës, aktet që plotësonin kriteret e dispozitave të mësipërme dhe që u konsideruan të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që ato kontribuonin për konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike, ndërsa refuzoi marrjen e provave të tjera të cilat nuk përmbushnin kriteret ligjore, por edhe nuk përmbanin vlera provuese në drejtim të situatës faktike të nevojshme për t'u saktësuar si bazë për zgjidhjen e çështjes.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

14. Kolegji mori fillimisht në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, në parashtrime e në seancë gjyqësore, lidhur me objektin 1+1 kate të ndodhur në Sarandë, të specifikuar si më poshtë.

14.1. Lidhur me pasurinë objekt 1+1 kate në Sarandë, me sipërfaqe trualli 304 m², të shitur në vitin 2004, subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit lidhur me shpenzimet e ndërtimit në vitin 2003, të cilat janë më të larta se shumata e deklaruar prej tij në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, janë kryer mbi përlllogaritje jo të drejta dhe, si të tilla, ato kanë ndikuar negativisht në analizën financiare të këtij viti. Gjithashtu konsideron të padrejtë edhe mospërfshirjen në analizën financiare të vitit 2004, të vlerës së përfituar nga shitja e këtij objekti.

14.2. Lidhur me këtë pasuri, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se: *Për arsye se subjekti ka deklaruar se investimi i ndërtimit të kësaj pasurie ka kushtuar 1.800.000 lekë dhe se për të provuar këtë deklaram, subjekti nuk depozitoi dokumentacion, Komisioni, për të nxjerrë koston reale të investimit, është bazuar në çmimet e Entit Kombëtar të Banesave mbi koston e ndërtimit. [...]*

Për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues investimin/shumën e shpenzuar për ndërtimin e objektit edhe pas prapësimeve, trupi gjykues nuk vlerëson të ndryshojë qëndrimin në rilloaritjen e këtij zëri financiar, i cili u referohet përlllogaritjeve sipas kriterëve ligjore të Entit Kombëtar të Banesave. Nga ana tjetër, trupi gjykues i ka qëndruar regjistrimit hipotekor, kontratës së shitjes (trajtuar gjerësisht në pikën 1.7), ku në secilën prej tyre pasqyrohet ndërtimi 1+1 dhe jo një regjistrim karabina. [...]

⁴ Raporti mjekësor nr. {***} regjistri, datë 17.02.2020, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr. {***}, Tiranë; raporti mjekësor nr. {***} regjistri, datë 28.02.2020, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr. {***}, Tiranë.

Për ndërtimin e objektit 1+1 kate në Sarandë, në vitin 2003, bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave në shumën 6.686.074 lekë, për të kryer të gjitha investimet gjatë vitit 1996 deri në vitin 2003, për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion justifikues vlerën e shpenzuar për ndërtimin e objektit dhe për pasojë ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e kësaj pasurie, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

14.3. Kolegji, në analizë të shkaqeve të ankimit të paraqitura prej subjektit, fillimisht shqyrtoi pretendimin e tij se objekti 1+1 kate, i ndodhur në Sarandë, nuk mund të jetë objekt kontrolli në funksion të procesit të tij të rivlerësimit, pasi kjo pasuri nuk ekzistonte në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting* sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji, këtë pretendim të subjektit, e konsideroi jo të drejtë dhe të pabazuar ligjërisht pasi, në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, objekt kontrolli janë jo vetëm të gjitha pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në pronësi apo përdorim në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe të gjitha burimet e financimit të këtyre pasurive. Në rastin objekt shqyrtimi, referuar deklaratimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, e ardhura e përfituar prej shitjes së pasurisë në fjalë, ka shërbyer si një prej burimeve të financimit për apartamentin në pronësi të subjektit, të ndodhur në Tiranë e të deklaruar me këtë status në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këto rrethana, Komisioni ka qenë krejtësisht i legjitimuar të kontrollojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie në kohën e krijimit të saj, si një veprim i detyrueshëm hetimor, në funksion të kontrollit të burimeve të krijimit të pasurisë në pronësi të subjektit e në përmbushje të parashikimit kushtetues dhe ligjor të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

14.4. Në vijim, Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka pasur një konkluzion të pasaktë referuar situatës faktike të pranuar se ka ekzistuar lidhur me fazën e ndërtimit të objektit 1+1 kate, të ndodhur në Sarandë dhe, për pasojë, edhe kostos së ndërtimit të tij. Vlerësimi dhe analizimi i këtij pretendimi u konsiderua prej Kolegjit i rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi dhe u realizua edhe në vlerësim të provave të reja të paraqitura prej subjektit me ankimin, përpos atyre të paraqitura e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

14.5. Kolegji mori në shqyrtim dhe analizë të gjitha të dhënat e dala nga aktet e fashikullit hetimor, por edhe ato të administruara gjatë gjykimit në Kolegji, për të përcaktuar dhe marrë qëndrime lidhur me çështjet:

1. faza e ndërtimit të objektit 1+1 kate, të ndodhur në Sarandë, në momentin e shitjes së tij në mars të vitit 2004;
2. vlera e kostos së ndërtimit të këtij objekti.

14.6. Lidhur me çështjen e parë, rezulton se Komisioni ka arritur në përfundimin se ndërtimi objekt verifikimi ka qenë i ndërtuar plotësisht në 1+1 kate të tij. Komisioni ka bërë një analizë të informacionit që i ka rezultuar prej akteve të administruara, sipas të cilave mbështetej konkluzioni i mësipërm. Në këtë drejtim, konstatohet se Komisioni arsyeton duke i dhënë një vlerë më të fortë provuesë aktit të kolaudimit të datës 20.10.2003 dhe kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.3.2004, sipas të cilave ndërtimi ka qenë i përfunduar dhe, si i tillë, është regjistruar në ZRVPP Sarandë, në raport me vlerën e diskutueshme që kanë sipas Komisionit, fotot e marra dhe të prezantuara prej subjektit prej platformave digjitale, si edhe pesha që kanë vetë deklaratimet e subjektit në këtë drejtim. Lidhur me këtë çështje, Komisioni rezulton se ka arsyetuar: [...] *Trupi gjykues, i ndodhur në këto rrethana konstatuese, në raport me deklaratimet e subjektit ndër vite, apo palëve (kolaudatorit, ndërtuesit, blerësit, deklaratime të kryera gjatë procesit të rivlerësimit), në referencë edhe të aktit vlerësues, çmon se konkurrojnë*

provat, siç është kontrata e shitjes së pasurisë, si dhe regjistrimi përkatës të cilët pasqyrojnë përfitimin e pasurisë dhe regjistrimin e objektit 1+1 të përfunduar.

Për shkak të konkluzionit që trupi gjykues arriti që në momentin e marrjes së vendimit për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore, për shkak të nevojës për të konstatuar saktë situatën faktike të konstatuar jo plotësisht prej Komisionit, arsyetimi në vijim i kësaj çështjeje do të ndërtohet në drejtim të analizës krahasimore të të dhënave, sipas të cilave Kolegji arriti në konkluzione mbi gjendjen faktike të ndërtimit në vitin 2004, e cila rezultoi të jetë e ndryshme nga ajo që ka konkluduar Komisioni.

14.7. Së pari, rezultoi se kjo godinë ka filluar të ndërtohet në vitin 2003, në zbatim të lejes së ndërtimit datë 24.12.2002, të dhënë nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë. Nga pamjet satelitore të përfuara prej platformës “Google Earth” të datës 05.07.2003, rezultoi se në këtë kohë, në sheshin në të cilin më pas shfaqet objekti i ndërtuar prej subjektit, nuk ka gjurmë ndërtimi të ndonjë lloji, element që i jep besueshmëri pretendimit të subjektit se ndërtimi ka nisur në muajin korrik 2003, siç edhe ai ka deklaruar në vazhdimësi. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003 si një objekt/ndërtim në gjendje të papërfunduar, i ndërtuar mbi truallin në pronësi të tij prej 304 m², të blerë prej seksionit të financës pranë Bashkisë Sarandë në vitin 2002⁵. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur ai edhe në përgjigjet që ka dhënë për pyetjet e Komisionit, të drejtuara në pyetësorët në vijim të procesit, si edhe më herët në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2005.

14.8. Kolegji konstatoi se përveç deklarimeve të subjektit, të cilat kanë qenë gjithmonë koherente dhe pa kundërshti për sa i përket faktit se ky objekt nuk është përfunduar së ndërtuari prej tij, por është shitur në gjendje karabina në nivelin 1+1 kate ndërtim, ai ka paraqitur në proces prova të natyrës së fotove digjitale për të provuar këtë pretendim të tij. Këto fotografi janë nxjerrë prej platformave digjitale të aksesueshme lirisht në internet, si nga ato shtetërore, si ASIG, por edhe nga ato të krijuara prej enteve private apo individëve të ndryshëm në mënyra dhe për qëllime të palidhura me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, siç janë *Google Earth*, FLIRC, të cilat janë disponuar prej subjektit nëpërmjet të dhënave të gjendura në burime të hapura (*open data*) duke plotësuar në këtë mënyrë rekuizitat e nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

14.9. Në mënyrë kronologjike, këto foto të kualifikuara si dokument, sipas dispozitës më sipër, por edhe parashikimit të nenit 278 të Kodit të Procedurës Civile, paraqesin pamjet të cilat u këqyrën prej trupit gjykues lehtësisht nëpërmjet këqyrjes vizuale të tyre, dhe nga të cilat rezultojnë disa fakte që u konsideruan të rëndësishme për arritjen e një konkluzioni për situatën faktike të marrë në shqyrtim. Përveç pamjeve që rezultojnë prej fotove të platformës *Google Earth* të korrikut 2003, nëpërmjet të cilave shihej se mbi sheshin e blerë prej subjektit⁶ nuk kishte asnjë ndërtim në këtë moment dhe ai gjendej në formë natyrore, Kolegji këqyri vizualisht pamjet që ofronin pamjet satelitore të po kësaj platforme të datës 14.04.2006 dhe të datës 21.08.2007, dy dhe tre vjet pas shitjes së objektit prej subjektit të rivlerësimit. Nga vlerësimi që u bëhet këtyre pamjeve, rezultoi se edhe në këto vite, pra në vitet 2006 e 2007, pasi objekti ishte shitur prej subjektit që në vitin 2004, ai shfaqet në to i papërfunduar e në gjendje karabina. Të njëjtat pamje, me qartësi edhe më të lartë rezultojnë të shihen në foto satelitore të marrë nga platforma shtetërore e gjeohapësirës ASIG⁷ në vitin 2007. Edhe në këto pamje, objekti shihet në lartësi jo më të madhe se 1+1 kate dhe me soletë të hapur e të papërfunduar. Pamjet e sjella

⁵ Subjekti ka blerë truallin me sipërfaqe 304 m² nga sektori i financës së Bashkisë Sarandë, me transaksionin bankar nr. {***}, datë 08.03.2002.

⁶ Nuk ka pasur asnjë diskutim në Komision dhe, prej hetimit, nuk kanë rezultuar të dhëna që e dyshojnë vendndodhjen e objektit të shfaqur e analizuar në pamjet digjitale.

⁷ Shih: <https://geoportal.asig.gov.al/>.

nga platforma FLIRC në vitin 2010, që paraqesin foto të objektit të bëra nga deti, pasqyrojnë tashmë një objekt me 4 kate, por përsëri të papërfunduar për sa i përket konstruksionit të tij. Të dhënat që përftohen nga këqyrja vizuale e pamjeve të mësipërme⁸, krijojnë për Kolegjin informacion të besueshëm nga burime të hapura e të besueshme në kuptim të nenit 49, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 se objekti 1+1 kate, i ndërtuar dhe i shitur prej subjektit në vitin 2004, nuk ka qenë një ndërtim i përfunduar në kuptim të parametrave të ndërtimit të një banese, siç ka konkluduar Komisioni.

14.10. Pamjet e renditura më lart, Kolegji i analizoi edhe në këndvështrim të të dhënave që vijnë nga akti i kolaudit, datë 20.10.2003 dhe kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.3.2004, prova të cilat janë përdorur prej Komisionit për të arritur në konkluzionin se ndërtimi ka qenë i përfunduar në kohën e shitjes së tij. Sipas aktit të kolaudit të datës 20.10.2003, të përcjellë nga ASHK Sarandë⁹, ky objekt referohet si i përfunduar. Kolegji vlerëson se përmbajtja e këtij akti nuk mundet objektivistisht t'i përgjigjet së vërtetës. Siç rezultoi nga pamjet satelitore të platformës *Google Earth* të korrikut 2003, sheshi në të cilin është ndërtuar ky objekt, ka qenë në gjendje natyrore në këtë kohë, fakt i pranuar edhe prej vetë Komisionit në vendim, duke e konsideruar atë si të pakontestueshëm, qoftë për shkak të gjurmës që ai ka lënë në një platformë deri tani të besueshme për vërtetësinë e informacionit që jep, por edhe për shkak se vetë Komisioni e konsideron të vërtetë. Në vlerësimin e Kolegjit, konsiderohet e pamundur në këndvështrim të parametrave teknikë e inxhinierikë, që për periudhën kohore korrik - tetor 2003, pra në harkun kohor të tre muajve të fillojë dhe përfundojë ndërtimi i një objekti 3 kate + garazh, siç ka pasqyruar akti i kolaudit. Akti i kolaudit përmban për më tepër një të pavërtetë të pranuar nga vetë Komisioni, që lidhet me numrin e kateve të ndërtuara, sipas këtij akti, ndërtimi ka përfunduar për gjithë godinën 3 kate + garazh sipas projektit dhe lejes së ndërtimit të miratuar, ndërsa vetë Komisioni në vendim pranon se ndërtimi nuk ka përfunduar në tërësinë e tij, por vetëm 1+1 kate, ndërsa i njeh atij vlerë të plotë provuese për sa i përket ndërtimit të plotë të dy kateve, në kundërshtim me të dhënat e tjera që vijnë nga fotot dhe deklaratimet e subjektit që në deklaratën fillestare të pasurisë.

14.11. Gjithashtu, duket se Komisioni i ka dhënë vlerë të plotë provues informacionit që vjen nga kontrata e shitjes së këtij objekti, e kryer në datën 28.03.2004. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, rezulton se nuk jepet asnjë përshkrim për gjendjen e pasurisë lidhur me fazën e saj ndërtimore. Në këtë kontratë, të cilën Komisioni e ka përdorur për të konkluduar se objekti ka qenë i përfunduar, nuk ka gjurmë eksplicite që lidhen me këtë konkluzion. Kontrata paraqet se shitësit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, janë bashkëpronarë të një pasurie me sipërfaqen dhe vendndodhjen përkatëse dhe të identifikuar me numrat e regjistrimit të saj në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në drejtim të interesave të palëve në një kontratë shitjeje, merr rëndësi thelbësore identifikimi i pronës, veçanërisht asaj të paluajtshme me të dhënat që ajo ka nga regjistrimi në regjistrat publikë. Përshkrimi në këta regjistra përkon me prezumimin ligjor se janë pronë e përfunduar, por ky prezumim nuk është një element i pakundërshtueshëm kur ai vihet në diskutim nga të dhëna që realisht duket se kundërshtojnë vërtetësinë e tij, siç është edhe rasti konkret.

Në këtë kuptim, ligji nr. 8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", datë 10.09.1998, i ndryshuar, në nenin 12/1¹⁰ parashikon mundësinë e regjistrimit të një objekti në

⁸ Në të njëjtin konkluzion kanë arritur edhe ekspertët urbanistë A. K. dhe J. Xh. për leximin teknik të këtyre pamjeve satelitore, konkluzion të cilin e kanë pasqyruar në akt ekspertimin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë në Komision.

⁹ Me shkresën nr. {***} port., datë 04.02.2020.

¹⁰ Në nenin 12/1 të ligjit nr. 8402, të ndryshuar, parashikohet se:

"Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me kërkesë të investitorit dhe pronarit, bën regjistrimin provizor të objektit në fazën e përfundimit të karabinasë dhe lëshon certifikatën përkatëse.

"Regjistrimi provizor" është regjistrimi i përkohshëm deri në përfundim të ndërtimit të objektit, i cili është i vlefshëm për efekt të kreditimit të investitorit ose të regjistrimit të kontratave paraprake.

fazën e karabinasë, e cila më pas ka gjetur reflektim në ligjin nr. 9701, datë 2.4.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në nenin 17¹¹ të tij, për t’i dhënë përgjigje shqetësimit praktik të shfaqur lidhur me këto situata. Legjislatori parashikoi me ndryshimet e mëvonshme ligjore edhe mundësinë e regjistrimit në këta regjistra të pasurive në gjendjen karabina, ndonëse për qëllime të ndryshme nga dokumentimi i tjetërsimit të pasurisë, por duke parashikuar ligjërisht situatën në të cilën mund të regjistrohej në regjistrat publikë një send i paluajtshëm, ndonëse ai nuk përfaqësonte një objekt të përfunduar, por ishte në gjendje karabina, që gjithsesi i jep sendit tiparet e një sendi të paluajtshëm.

14.12. Referuar në sa më sipër, konkluzioni se ndërtimi ka qenë i përfunduar pasi në këtë mënyrë përshkruan kontrata e shitjes dhe ajo ka vlerë të plotë provuese, nuk duket se përkon dhe gjen mbështetje në rastin konkret lidhur me këtë element. Vlera provuese e kontratës në lidhje me këtë element, për të cilin kontrata ometon të ketë një përshkrim, duhet të përcaktohet në raport me informacionin që japin aktet e tjera të administruara gjatë procesit, lidhur me rrethanën e ometuar, përderisa deduksioni që vjen në interpretim të saj, vihet seriozisht në diskutim prej tyre.

14.13. Kolegji mori në analizë në këtë drejtim edhe përmbajtjen e shkresës nr. {***} prot., datë 23.05.2022, të ASHK Sarandë, drejtuar subjektit, në të cilën pasqyrohet ndër të tjera se: *Në këtë rast specifik, Bashkia Sarandë nuk ka përcjellë për regjistrim dokumentacionin për regjistrimin e objektit në fazën e karabinasë, por për regjistrimin e objektit të përfunduar edhe pse gjendja e tij mund të ketë qenë karabina, pra e papërfunduar, duke sjellë si rrjedhojë regjistrimin e tij në ZRVPP sipas dokumentacionit të përcjellë dhe jo sipas kërkesës së pronarit/investitorit. Sjellim në vëmendjen tuaj se mënyra e dokumentacionit të përcjellë në këtë formë nga ana e Bashkisë Sarandë, është evidentuar si praktikë në disa raste gjatë periudhës 1998-2003. Më saktësisht, si rast analog, rezulton në librin hipotekor nr. {***}, f. {***}, nr. {***} indeksi, viti 2000, në emër të shoqërisë “{***}” ShPK rezulton e regjistruar pasuria e llojit “Hotel-Restorant” me 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë si e përfunduar [...] objekti i cili edhe realisht sot është ende në stadin e karabinasë.*

Sipas këtij informacioni, regjistrimi i pasurisë si i përfunduar, jo domosdoshmërisht pasqyron realitetin e objektit, por ai vjen në raste të caktuara edhe për shkak të plotësimit të formaliteteve që nevojiten për të mundësuar disponimin lirisht të pronës, i cili nuk realizohet në mungesë të regjistrimit të saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Në këtë kuptim, Kolegji merr me rezervë vlerën provuese të këtyre akteve lidhur me këtë element, i cili rezulton të jetë përshkruar në to për nevoja të tjetërsimit të pasurisë, për sa kohë informacioni që vjen prej perceptimit shqisor të drejtpërdrejtë të pamjeve satelitore të kohës, krijon bindjen për ekzistencën e një shtate të ndryshme në këtë drejtim.

14.14. Përfundimisht, lidhur me gjendjen/fazën e ndërtimit të objektit 1+1 kate, të ndodhur në Sarandë, në momentin e shitjes së tij në mars të vitit 2004, Kolegji, duke vlerësuar të gjitha të dhënat që rezultojnë nga burime të njohura e të besueshme e duke i analizuar ato në harmoni e në raport me njëra-tjetrën, në përputhje me parashikimin ligjor të nenit 49, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, krijon bindjen se ky objekt ka qenë i papërfunduar në gjendje karabina në momentin që subjekti i rivlerësimit e ka shitur atë.

“Karabina” është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën e plotë të objektit”.

¹¹ Në këtë nen parashikohet se:

“Regjistruesi, me kërkesë të investitorit dhe të pronarit, bën regjistrimin e përkohshëm të objektit në fazën e përfundimit të karabinasë, si dhe lëshon certifikatën përkatëse, në përputhje me nenin 12/1 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Ky regjistrim bëhet me kolonë të ndryshme nga ajo e truallit, në të cilin po kryhet ndërtimi dhe është i vlefshëm deri në përfundimin e objektit, për efekt të kreditimit të investitorit ose regjistrimit të kontratave paraprake”.

15. Lidhur me çështjen e dytë që shtrohet për zgjidhje, në raport me shkaqet e ankimit të ngritura prej subjektit e që i referohet *vlerës së kostos së ndërtimit të objektit të analizuar më lart*, Kolegji mori në analizë konkluzionet e Komisionit në raport me përfundimin e arritur prej trupës gjyquese si më lart arsyetuar, se ky ndërtim ka qenë i papërfunduar në momentin e shitjes së tij.

15.1. Lidhur me këtë çështje, nga aktet e fashikullit dhe vendimi objekt shqyrtimi rezulton se kostot e ndërtimit të tij janë përlllogaritur sipas të dhënave të udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2003, të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) për çmimet e ndërtimeve në Sarandë në vitin 2003. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit, sipas të cilit përlllogaritja e kostos së ndërtimit të këtij objekti është bërë si për një objekt të përfunduar, duke aplikuar çmimet e EKB-së të vitit 2003, duke e konsideruar këtë përlllogaritje si tërësisht të padrejtë dhe që ka ndikuar negativisht analizën financiare të subjektit për atë vit. Lidhur me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një akt të ri ekspertimi të datës 29.06.2020, të hartuar nga eksperti i licencuar A. G., i cili mban qëndrimin se: *[...] kostoja e ndërtimit e një objekti 1+1 kate, me sipërfaqe ndërtimi 120 m², shkon në rreth 35% të kostos së plotë të ndërtimit të tij. Duke marrë për bazë kostot referuese të Entit Kombëtar të Banesave të vitit 2003, objekti në këtë rast ka një kosto ndërtimi që shkon rreth vlerës 2.088.924 lekë, bashkë me truallin e blerë nga Bashkia.*

15.2. Për t’i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, Kolegji e sheh me vend *së pari* të nënvizojë qëndrimin e tij se përderisa nga analiza e të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ e gjyqësor, është konkluduar se objekti i shitur prej subjektit të rivlerësimit ndodhej në gjendje të papërfunduar/karabina, përlllogaritja e vlerës së shpenzuar si kosto për ndërtimin e tij me çmimet e përcaktuara prej EKB-së, të cilat i referohen një ndërtimi të përfunduar¹², konsiderohet si e padrejtë. Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji mori në shqyrtim kriteret që duhen përdorur për të përlllogaritur vlerën e kostos së ndërtimit në rastin konkret, duke analizuar të dhënat që vijnë nga aktet në fshikull në raport me rregullimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Për këtë qëllim, Kolegji, pasi u njoh edhe me qëndrimin e aktit të ekspertimit të ekspertit A. G., tek i cili referohet se kostot e një ndërtimi në fazën e karabinasë përfaqësojnë 35% të kostove të një ndërtimi të përfunduar, kreu një analizë të kuadrit ligjor rregullator të kostove të ndërtimit në kohën respektive, nga e cila u konstatua që gjenden referenca për përcaktimin e kostove të ndërtimit për objektet në fazën e karabinasë në raport me ato të ndërtimit të përfunduar në ndonjë akt ligjor apo nënligjor. Në funksion të kësaj analize, Kolegji konstatoi *së pari* se EKB-ja, ndër vite, ka publikuar kostot e ndërtimit për objekte të përfunduara dhe nuk ka referime për kostot e ndërtimit në fazën e themeleve apo të karabinasë¹³. *Së dyti*, si akt nënligjor i cili përcakton për qëllime fiskale kostot e ndërtimit të një strukture, objekti i cili për

¹² Në udhëzimin e EKB-së nr. 1, datë 08.05.2003, si dhe në të gjitha udhëzimet për vitet e tjera si ato pararendëse dhe në vijim, përcaktohet se:

“1. Kostoja e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave në shkallë republike, për vitin 2003, të jetë 29.253 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) leke/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, për qytetin, për vitin 2003, të jetë sipas tabelës “Të dhëna për tregun e lirë të apartamenteve”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi”.

Nga analizimi i këtyre përcaktimeve të këtij udhëzimi, konstatohet se çmimi i identifikuar në të i referohet sipërfaqes së shfrytëzimit, e cila, referuar ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, përcakton (në nenin 13) se dhënia e lejes së shfrytëzimit bëhet nga seksioni ose zyra e urbanistikës e njësisë vendore brenda 30 ditëve pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit. Gjithashtu ky udhëzim referon se vlera e identifikuar në të bazohet gjithashtu edhe në të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve, të cilat në një arsyetim të logjikshëm konsiderohen si të tilla pasi të kenë përfunduar.

¹³ Në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, në nenin 12/1, përcaktohet se: “Karabina” është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën e plotë të objektit.

nga përshkrimi për afrohet me atë të karabinasë, ishte dokumenti i hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave i emërtuar *Udhëzues për zbatimin e VKM nr. 173, datë 29.03.2006 "Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave"*, si dhe marrëveshjen së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë. Ky udhëzues parashikon se në praktikë mund të hasen raste kur kërkohet analizë më e thellë e strukturës dhe e kostove të ndërtimit sipas fazës së ndërtimit të objektit, duke paraqitur një orientim për përcaktimin e kostos së ndërtimit të garazheve, për qëllime fiskale, për afërsisht sa ½ kostos për metër katror të ndërtimit të përfunduar që i përket ky garazh. Pra, sipas këtij udhëzuesi, kostoja e ndërtimit të një garazhi do të llogaritet sa ½ e kostos së ndërtimit të objektit që i përket ky garazh. Në këtë kontekst, Kolegji konstaton se sipas këtij akti rregullator/orientues, ka një koncept të pranuar nga entet që operojnë në fushën e ndërtimit, por edhe përcaktimit të çmimit për qëllime fiskale, se kostoja e një ndërtimi të tipit garazh, të cilit i mungojnë shumë elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar të tipit banesë, nga ato për të cilat EKB-ja në bazë të VKM-ve përkatëse, përcakton çmimet referuese, është pa dyshim e ndryshme dhe duhet të trajtohet si e tillë edhe për qëllime fiskale, diferencë e cila orientohet të jetë në masën 50% të çmimit referues. Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh se garazhi është një objekt i cili, për nga pikëpamja strukturore, i për afrohet karabinasë, në kuptimin që kanë elemente të përbashkëta për nga niveli i investimit, ndonëse garazhi përsëri mbetet një objekt i përfunduar në llojin e vet, Kolegji analizoi konkluzionin e ekspertit në aktin e ekspertimit të përshkruar më lart, sipas të cilit vlera e ndërtimit të një objekti në gjendje karabina është përgjithësisht në vlerën sa 35% e vlerës së ndërtimit të përfunduar, si një referim që dukej se mund të për afrohej me përcaktimin e këtij akti rregullues. Krahas këtij elementi, Kolegji analizoi edhe qëndrimet referuese të mbajtura në disa vendime të dhëna prej tij rreth kostos së një objekti të ndërtuar deri në fazën e karabinasë, që variojnë në një raport nga 40-42% e çmimit referues sipas EKB-së¹⁴. Në këndvështrim të vlerave që rezultojnë të për llogaritura prej këtyre raporteve, krahasuar me çmimin referues të EKB-së të përcaktuar nga Komisioni, rezultoi se ato kishin për afërsi me vlerën e përcaktuar si çmim nga kontrata e shitjes së objektit, prej 1.800.000 lekësh¹⁵.

15.3. Në këto kushte, në mungesë të një akti ligjor/nënligjor që përcakton çmime reference ndërtimi për objektet në fazën e karabinasë, duke vlerësuar se: **(i)** nuk ka të dhëna specifike që përcaktojnë gjendjen ekzistuese të objektit apo investimin e kryer për ndërtimin e tij në kohën e shitjes, të cilat do të mund të përcaktonin vlerën më të për afërt të ndërtimit; **(ii)** faktin se subjekti nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor sipas ligjit të kohës nr. 9049/2003, të ruajë dokumentacion që provon elementet strukturore të ndërtimit të një objekti i cili, për më tepër që në deklarinimin fillestar të vitit 2003, ka qenë një pasuri që nuk disponohej më prej subjektit sepse ishte shitur me kontratën e datës 28.03.2004 dhe nuk kishte një pritshmëri për një rregullim të mëvonshëm të kësaj situate, si ajo e parashikuar prej ligjit nr. 84/2016; **(iii)** faktin që vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes së objektit u për afrohet vlerave referuese që rezultojnë sipas metodologjisë së përdorur prej Kolegjit në raste të ngjashme apo asaj të përcaktuar në aktin e ekspertimit; **(iv)** faktin që subjekti në versionin që mund të kishte deformuar çmimin e shitjes së objektit në kontratë në favor të interesave të tij, sipas vlerësimit të Kolegjit, do ta kishte rritur atë artificialisht në funksion të justifikimit të pasurive të tjera të blera më pas, duke qenë se kjo rezultonte më e volitshme në konsideratë edhe të vlerës së tatimit

¹⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. (JR) 35/2021, datë 23.11.2021 dhe nr.(JR) 22/2020, datë 16.09.2020.

¹⁵ Për të identifikuar kostot e ndërtimit të karabinasë nga Kolegji, analiza u krye me disa alternativa:

- Duke aplikuar si kosto ndërtimi në masën 42% të çmimit referues të EKB-së, vlera e ndërtimit në Sarandë rezultoi 2.331.604 lekë.
- Duke aplikuar si kosto ndërtimi në masën 35% të çmimit referues të EKB-së (sipas aktit të ekspertimit të ekspertit A. G.), vlera e ndërtimit në Sarandë rezultoi 1.943.004 lekë.

që duhej të paguante sipas ligjit të kohës¹⁶; (v) faktin që logjikisht, subjekti nuk mund të shiste më lirë një pasuri për të cilën kishte shpenzuar më shumë edhe në këndvështrim të kontekstit kohor kur ndërgjegjësimi rreth provueshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie ishte i paformuar, duke qenë se ligji nr. 9049/2003 sapo ishte miratuar dhe nuk kishte filluar të zbatohet ende, në aplikim të nenit 49, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 pranon si të besueshëm pretendimin e subjektit se çmimi i shitjes së objektit sipas kontratës së shitjes nr. 1355 rep., nr. 365 kol., datë 28.3.2004, në vlerën prej 1.850.000 lekësh, përfaqëson edhe vlerën e kostos së ndërtimit të tij.

15.4. Në konkluzion të kësaj analize, mbështetur në arsyetimin e mësipërm, Kolegji arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i gabuar për sa i përket konstatimit të faktit se ndërtimi ka qenë një objekt i përfunduar dhe, si i tillë, duhej të aplikoheshin për përcaktimin e kostove për ndërtimin e tij, çmimet e përcaktuara prej EKB-së për objekte të përfunduara. Kolegji, në analizë të të dhënave që vijnë prej deklaratave periodike të pasurisë të viteve 2003 e 2004, pamjeve fotografike të fiksuara prej platformave digjitale, përfshirë edhe ato të agjencive shtetërore, si edhe analizimin harmonik e krahasimor të të gjithë informacionit që vjen nga dokumentacioni i administruar, vlerëson se objekti i ndodhur në Sarandë, i ndërtuar prej subjektit në vitin 2003 dhe i shitur në mars të vitit 2004, ka qenë në gjendje të përfunduar në këtë kohë. Për pasojë, kostoja e ndërtimit të tij nuk mund të llogaritet sipas çmimeve të miratuara prej EKB-së, të cilat i korrespondojnë një objekti të përfunduar. Kolegji, duke vlerësuar si të besueshëm informacionin e dhënë prej subjektit në mënyrë përshkruese e të detajuar në deklaratat periodike dhe në kontratën e shitblerjes së këtij objekti të kryer në vitin 2004, në mungesë edhe të ndonjë indicieje apo të dhëne që tregonte të kundërtën, krijoi bindjen se subjekti e ka shitur këtë objekt me të njëjtën vlerë të shpenzuar për ndërtimin e tij, dhe se kjo shumë, prej 1,8 milionë lekësh, do të duhet të konsiderohet si vlera e shpenzuar për ndërtimin e objektit dhe duhet të përfshihet në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme, të përdorura për krijimin e kësaj pasurie.

16. Në vijim, Kolegji shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat ai kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me burimin e ligjshëm të huave të marra nga personi tjetër i lidhur, shtetasi A. M. (vëllai i bashkëshortes), në vitet 2003-2004, në shumën 2.000.000 lekë, pjesërisht të përdorura si burim krijimi për ndërtimin e objektit 1+1 kate, në Sarandë (1.000.000 lekë) dhe për blerjen e apartamentit në Tiranë (1.000.000 lekë), duke pretenduar se këto të hua (të shlyera plotësisht nga subjekti) janë krijuar prej huadhënësit me burime të ligjshme të rrjedhura prej:

- a) të ardhurave të siguruara prej punësimit të tij si agjent doganor në agjencinë doganore “{***}” ShPK, në periudhën 1995-1997;
- b) të ardhurave të siguruara në emigracion, prej punësimit të tij si mekanik në traqetin “{***}”, në periudhën janar 1998 - maj 2001;
- c) të ardhurave të siguruara prej punësimit të tij pranë ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime në periudhën qershor 2001 - qershor 2012;
- ç) të ardhurave të siguruara prej punësimit të tij me kohë të pjesshme në kompaninë “{***}” në periudhën 2004-2008.

16.1. Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, lidhur me huan e marrë nga shtetasi A. M., duke e konsideruar këtë të fundit si person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe

¹⁶ Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, kalimi i së drejtës të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme tatohej si në vijim:

- për objekte me vlerë nga 0 deri në 2.000.000 lekë - vlera e tatimit 0,5% e çmimit të shitjes;
- për objekte me vlerë mbi 2.000.000 lekë deri në 4.000.000 lekë - vlera e tatimit 1% e çmimit të shitjes;
- për objekte me vlerë mbi 4.000.000 lekë deri në 6.000.000 lekë - vlera e tatimit 2% e çmimit të shitjes;
- për objekte me vlerë mbi 6.000.000 lekë - vlera e tatimit ishte sa 3% e çmimit të shitjes.

nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është konkluduar se: *Megjithëse subjekti pretendon se ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumente që të justifikonin të ardhurat e shtetasit A. M., trupi gjykues vlerëson nga njëra anë jo vetëm që ky pretendim nuk u provua, pasi nuk u vërtetua përmbushja e kushteve ligjore që kërkon pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, por nga ana tjetër nuk i çmon arsyet e paraqitura si shkaqe të arsyeshme për vetë faktet e konstatuara, të lidhura me provueshmërinë e marrëdhënies së punësimit, pa u provuar kështu burimi i ligjshëm i shumës së dhënë hua. Në të tilla kushte, trupi gjykues arrin në konkluzion se: Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës, dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të huas në shumën 2.000.000 lekë, të marrë shtetasit A. M..*

16.2. Kolegji konstaton se Komisioni ka verifikuar burimet e krijimit prej personit tjetër të lidhur A. M., të shumave të dhëna hua subjektit të rivlerësimit në vitet 2003-2004 dhe 2007, duke qenë se këto hua kanë shërbyer për krijimin e pasurive të subjektit, respektivisht objektit 1+1 kate në Sarandë, apartamentit në pronësi të subjektit të ndodhur në Tiranë, të blerë në vitin 2004, si edhe për financimin e blerjes së një garazhi në vitin 2007. Nga hetimi administrativ, Komisioni ka konkluduar se personi tjetër i lidhur justifikon burimet e krijimit të shumës së dhënë hua në vitin 2007, ndërsa nuk arrin të provojë me dokumentacion krijimin e tyre me burime të ligjshme në vitet 2003-2004.

16.3. Në drejtim të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, Kolegji e sheh me vend *së pari*, të bëjë një vlerësim të përgjithshëm për deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me huat e dhëna atij prej personit tjetër të lidhur A. M.. Konstatohet se subjekti ka deklaruar huat e dhëna nga ky shtetas së pari në deklaratën *vetting*, duke i përcaktuar ato si burim specifik për krijimin e pasurive të deklaruara në këtë deklaratë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Përpos këtij deklarimi në rubrikën e deklaratimit të pasurive, në zërin “burime të krijimit”, subjekti ka bërë një përshkrim shterues rreth marrëdhënies me personin tjetër të lidhur A. M. në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, duke përshkruar shumat e dhëna hua apo dhuruar bashkëshortes së tij prej këtij shtetasi në vite, si edhe burimet e krijimit të tyre. Krahas pjesës përshkruese, subjekti ka pasqyruar në këtë rubrikë edhe të gjitha kontratat noteriale me ekstremitet përkatëse që kanë shërbyer në vitet 2006-2010, për të formalizuar qoftë marrjen e huave, qoftë kthimin/shlyerjen e tyre. Me të njëjtën vëmendje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë marrëdhënie që në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, si dhe në të gjitha deklaratat periodike në vite, kur ka pasqyruar marrjen hua dhe shlyerjen e tyre vit pas viti. Në DPV-në e vitit 2004, ka dhënë në fund të fletës ku gjendet rubrika e detyrimeve financiare edhe numrin e telefonit të huadhënësit. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se subjekti ka bërë deklarime të sakta e të plota lidhur me marrëdhënien e huamarrjes me personin tjetër të lidhur A. M., të cilat rezultojnë në përputhje e harmoni edhe me faktet e pasqyruara në kontrata respektive noteriale e krijojnë një tablo të qartë e lehtësisht të kontrollueshme nga pikëpamja e deklarimeve për organet e rivlerësimit.

16.4. Në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme të cilat kanë mundësuar krijimin e shumave të dhëna hua prej personit tjetër të lidhur A. M., Kolegji u ndal në analizimin e krijimit të shumës prej 1.000.000 lekësh, dhënë në vitin 2003 e që ka shërbyer si burim financimi për objektin 1+1 kate, në Sarandë, si dhe të shumës prej 1.000.000 lekësh, dhënë në vitin 2004 që ka shërbyer si burim për financimin e blerjes së apartamentit në pronësi të subjektit, të ndodhur në Tiranë, duke përjashtuar nga kontrolli krijimin e shumës së dhënë hua në vitin 2007, për të cilën Komisioni ka konkluduar se justifikohet me burime të ligjshme. Në kryerjen e këtij kontrolli, Kolegji iu referua të njëjtave provave që ka administruar edhe Komisioni, duke qenë se në këtë drejtim, nuk u morën prova të reja në gjykim.

16.5. Komisioni me të drejtë, në referim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e ka konsideruar A. M. si person tjetër të lidhur të subjektit të rivlerësimit për të cilin ka kryer analizën ekonomike me qëllim për të identifikuar nëse ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar shumën 2.000.000 lekë, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit (*siç ka deklaruar në DPV subjekti, në shumat 1.000.000 lekë në vitin 2003 dhe 1.000.000 lekë në vitin 2004*).

16.6. Komisioni ka konkluduar se me dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, nuk mund të provohet marrëdhënia e punësimit të këtij shtetasi në tragetin “{***}”, pasi i gjithë dokumentacioni që disponohet në fashikull, mbetet në nivel deklarativ, *sepse mungon kontrata e punës, mungojnë listëpagesat, si dhe mungojnë provat për shlyerjen e detyrimeve tatimore apo çdo dokument tjetër që provon se realisht janë marrë këto të ardhura*. Pas këtij konkluzioni, Komisioni ka vijuar analizën e të ardhurave të tjera të personit tjetër të lidhur A. M. për periudhën 1996 - mars 2004, nga e cila ka rezultuar se ky shtetas ka përfituar vlerën 1.023.988 lekë dhe ka arritur në konkluzionin se këto janë të pamjaftueshme për të provuar burimin e të ardhurave të krijimit të shumës 2.000.000 lekë, të dhëna hua subjektit..

16.7. Nga aktet e administruara në fashikullin e hetimit administrativ, të depozituara prej subjektit të rivlerësimit për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të shumave të mara hua, prej 1.000.000 lekësh në vitin 2003 dhe 1.000.000 lekësh në vitin 2004, rezulton se ato i përkasin dokumentacionit me anë të të cilit subjekti ka tentuar të provojë: i) marrëdhënien e punësimit të personit tjetër të lidhur për periudhën janar 1998 – maj 2001, si mekanik në tragetin “{***}” dhe të ardhurat e krijuara prej saj; ii) të ardhurat nga agjencia doganore “{***}” ShPK në vitet 1996-1997; iii) të ardhurat nga punësimi në ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime për periudhën janar 2001 – mars 2004; iv) të ardhurat e siguruara nga punësimi pranë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë në periudhën prill 2004 – 2007.

16.8. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të personit tjetër të lidhur si mekanik në tragetin “{***}”, i cili, në periudhën 1998-2001, bënte udhëtime në linjën Korfuz-Sarandë, subjekti ka pretenduar se kunati i tij, por edhe ai vetë, me gjithë kërkimet e plota që kanë bërë, nuk kanë arritur të gjejnë dokumentacion që provon në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhënien e punës dhe pagën përkatëse, as dokumentacion që provon përfitimin e kësaj page dhe pagimin e detyrimeve tatimore prej punëdhënësit (pronari i anijes), i cili ka qenë një shtetas grek. Subjekti ka pretenduar se ka qenë në pamundësi për të provuar me dokumentacion ligjor qoftë marrëdhënien e punësimit, ashtu edhe veçanërisht të ardhurën dhe pagesën e detyrimeve tatimore, për shkak të një sërë rrethanash objektive që janë specifike në rastin konkret. *Së pari*, punësimi i personit tjetër të lidhur është kryer në një anije me flamur të huaj, të Hondurasit, me pronar një shtetas të huaj, grek. Vetë marrëdhënia e punës, sipas pretendimit të subjektit, ka qenë e rregulluar nga legjislacioni i huaj, për shkak të normave ndërkombëtare, legjislacioni honduras ose grek. *Së dyti*, anijet në pronësi të shoqërisë punëdhënëse kanë ndërprerë udhëtimin në këtë linjë prej shumë vitesh, duke shkëputur lidhjet me Shqipërinë dhe vetë individët që kanë punuar për to. Kunati i subjektit të rivlerësimit nuk ka arritur të kontaktojë shtetasin grek A. G.¹⁷, që ka qenë punëdhënësi i tij, megjithëse ka bërë të gjitha përpjekjet për ta kontaktuar atë. Në mungesë të dokumentacionit që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të provonte këtë marrëdhënie të pretenduar dhe pagesën e përfituar prej saj, subjekti ka paraqitur përgjatë hetimit administrativ një grup aktesh me të cilat ai kërkon të provojë qoftë edhe në mënyrë të tërthortë faktin që kunati i tij A. M. ka punuar në anijen e kësaj shoqërie për periudhën 1998-2001 dhe është paguar me një pagë prej 150.000 dhrahmish në muaj.

¹⁷ E-mail i dërguar nga adresa e z. A. M. ({***}), datë 03.04.2020, drejtuar shtetasit grek, pronar i anijes, me adresë elektronike: {***}; e-mail i dërguar nga adresa e elektronike e z. A. M. ({***}), datë 03.04.2020, drejtuar: {***}.

16.9. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, mbështetur në dokumentacionin e administruar, Komisioni duhet të arrijë në konkluzionin se marrëdhënia e punësimit të personit tjetër të lidhur A. M. ishte provuar edhe nëse nuk do të merret për bazë paga¹⁸ prej 150.000 dhrahmish/muaj, e deklaruar nga dëshmitarët, atëherë Komisioni duhet t'i referohej pagës minimale mujore sipas Institutit të Statistikave të shtetit helen. Në këtë drejtim, subjekti kërkon gjithashtu prej Kolegjit të konsiderojë se, sipas ligjit, detyrimin për të paguar detyrimet tatimore e ka pasur dhe e ka punëdhënësi. Në tërësinë e kërkimeve të ankimit dhe parashtrimeve gjyqësore, subjekti kërkoj që në analizën e kryer nga Kolegji për personin tjetër të lidhur A. M., edhe në versionin që nuk konsiderohen të ardhurat e siguruar nga punësimi si marinar, të konsiderohen ato të ardhura për të cilat provohet se huadhënësi ka paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit të aplikueshëm në kohën kur ato janë krijuar.

16.10. Për të provuar sa më lart, rezulton se subjekti ka paraqitur dokumentacionin që është administruar prej Komisionit, nga i cili konstatohen të dhënat e mëposhtme.

1) Deklarata noteriale të z. G. M., z. S. Z., z. I. T.¹⁹, të cilët deklarojnë se kanë punuar në të njëjtën kohë me shtetasin A. M., në tragetet e linjës Korfuz-Sarandë, me një pagë mujore prej 150.000 dhrahmish greke²⁰.

2) Shkresa nr. {***} prot., datë 12.12.2019, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila konfirmon regjistrimin e mjetit lundrues “{***}” për transport pasagjerësh, si dhe konfirmon destinacionin e udhëtimit Sarandë - Korfuz për vitet 1997 – 2001. Gjithashtu, shkresa pasqyron prekjet e këtij mjeti në port, frekuencat e tyre, si dhe identifikon dhe kapitenin e tij, shtetasin G. M., në këto vite. Subjekti pretendon se kjo shkresë konfirmon deklaratimet e tij për ekzistencën e tragetit dhe qenien e tij funksional në linjën e pretenduar, si edhe konfirmon pozicionin e shtetasit G. M. si kapiten i tragetit, duke u dhënë një vlerë të provuese deklarimeve të tij qoftë për punësimin, qoftë për pagën e paguar personit tjetër të lidhur.

3) Shkresa nr. {***} prot., datë 12.12.2019, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, në të cilën konfirmohet që trageti “{***}” ka kryer nga viti 1997 - 2001 linjën Korfuz – Sarandë, me frekuencë lëvizjeje pothuaj të përditshme.

4) Shkresa me nr. {***}, datë 28.1.1998, e lëshuar nga Autoriteti Portual Korfuz, e emërtuar “Seaman’s dock pass” (lejedalje në port), sipas së cilës vërtetohet zyrtarisht se shtetasi A. M., i biri i M., i datëlindjes 1971, me nr. pasaporte {***}, me kombësi shqiptare, është marinar në tragetin “{***}”, anije me port regjistrimi Honduras.

5) “Pasaportë lundrimi/Seaman’s book”, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, Kapiteneria e Portit Sarandë, me nr. {***}, datë lëshimi 22.1.1998, e vlefshme deri më datë 31.12.1999, sipas së cilës vërtetohet se shtetasi A. M., i biri i M., i datëlindjes 17.08.1971, lindur në Sarandë, është imbarkuar në datën 10.1.1998 në tragetin “{***}”, në detyrën mekanik, në portin e Korfuzit.

6) Lejedalje në breg, me specialitetin “marinar”, me nr. {***}, lëshuar datë 28.01.1998, nga Autoriteti Portual Korfuz.

7) Pasaportë detari, lëshuar nga Kapiteneria e Portit Durrës, sipas së cilës A. M. ka pozicionin e Chief Eng. me nr. {***}, lëshuar më datë 06.01.2001, e vlefshme deri më datë 31.12.2002. Krahas këtyre akteve, subjekti ka paraqitur edhe dokumentacion që provon të ardhurat e krijuara prej personit tjetër të lidhur nga punësimi i tij në agjencinë doganore “{***}” ShPK dhe në ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime Sarandë.

¹⁸ Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e personit të lidhur A. M., për periudhën 1996 - korrik 2003 duhet të përlllogariten në masën 3.456.082 lekë, të cilave duke iu shtuar dhe të ardhurat për periudhën gusht 2003 - mars 2004, duhet të jenë në total në vlerën 3.745.378 lekë.

¹⁹ G. M. ka lëshuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të datës 06.12.2018; I. T. ka lëshuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr {***}kol., datë 29.08.2018; S. Z. ka lëshuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr {***}kol., datë 27.08.2018.

²⁰ Rreth 75.000 lekë sipas kursit mesatar²⁰ të Bankës së Shqipërisë në vitin 1998.

16.11. Kolegji, duke analizuar pretendimin e subjektit për të ardhurat e krijuara nga punësimi i kunatit të tij në tragetin “{***}” në periudhën 1998-2001, pasi shqyrtoi aktet e cituara më lart, arriti në konkluzionin se ndonëse krijohet bindja se personi tjetër i lidhur ka pasur një marrëdhënie punësimi me shoqërinë që administronte tragetin “{***}”, nuk u provuan elemente të rëndësishme të kësaj marrëdhënieje punësimi, si afati kohor i zgjatjes së saj, të ardhurat e përfituara apo pagimi i detyrimeve tatimore që lidhen me këto pagesa. Për këto arsye, është e pamundur për Kolegjin të përcaktojë një vlerë konkrete e cila do të përfaqësonte të ardhurën e ligjshme të krijuar prej këtij shtetasi nga ky punësim, pasi informacioni që vjen për pagën lidhet vetëm me deklaratimet e shtetasve që kanë punuar njëkohësisht me të në tragetet e shoqërisë dhe jo nga ndonjë dokument zyrtar.

16.12. Qëndrimin e mësipërm lidhur me vlerësimin e situatës faktike, Kolegji e vlerësoi gjithashtu në raport me specifikën e këtij regjimi punësimi, i cili rezultoi i parregulluar ligjërisht nga legjislacioni shqiptar i kohës kur ajo ka ndodhur. Nga kërkimet e kryera në drejtim të përcaktimit të rregullave për të normuar një marrëdhënie të tillë, rezultoi se në këtë periudhë, 1998 – 2001, vendi nuk kishte ende një kuadër rregullator të miratuar që normonte marrëdhëniet në fushën e detarisë, madje edhe ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 (i cili ka hyrë në fuqi më 01.07.2005), Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nuk përcaktonte detyrime të qarta lidhur me rregullimin e punësimit apo pagimin e detyrimeve tatimore mbi pagën nga punëdhënësi në këto lloj marrëdhëniesh, në të cilat ka element të huaj, pasi, si punëdhënësi, ashtu edhe vendi ku kjo punë kryhej, janë të huaj. Në këtë kuptim, duke konsideruar se marrëdhënia e punësimit rezultoi të ketë qenë e lidhur me një shoqëri greke, e cila administronte një anije të regjistruar në Honduras, e bën të vështirë edhe në kushtet e sotme, pas miratimit të Kodit Detar e ratifikimit të Konventës “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të konventës ndërkombëtare “Për standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët (STCW)1978”, me ligjin nr. 82/2019, datë 05.12.2019, përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm sipas të cilit do të përcaktoheshin detyrimet e të drejtat mes palëve në një marrëdhënie të tillë e, për pasojë, edhe mënyrat e deklaratimit të pagesave e pagimit të detyrimeve tatimore e sigurimeve shoqërore. Në këtë kuptim, ndonëse Kolegji nuk përcaktoi një vlerë që vjen nga kjo marrëdhënie për ta përfshirë në analizën që do t’u bëhet të ardhurave të ligjshme të personit tjetër të lidhur, në funksion të kontrollit të burimeve për krijimin e shumës së dhënë hua në vlerën prej 2.000.000 lekësh, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, do të mbajë parasysh rrethanat e mësipërme në vlerësimin që do t’u bëjë mundësive financiare të personit tjetër të lidhur dhe veçanërisht peshën që do të ketë kjo situatë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

16.13. Përveç sa më sipër, Kolegji mori në analizë të ardhurat e tjera të krijuara prej personit tjetër të lidhur A. M., në periudhat e pretenduara prej subjektit të rivlerësimit, të cituara edhe në paragrafët më lart, për të cilat provohej pagesa e tyre nga marrëdhëniet e punësimit dhe detyrimet tatimore sipas parashikimeve ligjore. Sipas kësaj analize, Kolegji vlerësoi të ardhurat e dokumentuara në raport me shpenzimet e jetesës të kryera nga personi tjetër i lidhur në këtë periudhë dhe llogariti mundësinë e kursimit të tij vetëm në konsideratë të këtyre të dhënave.

16.14. Nga kjo analizë, Kolegji konstatoi se për periudhën janar 2001 - korrik 2003 (duke përfshirë dhe të ardhura nga punësimi si agjent doganor pranë “{***}” “ShPK, për vitet 1996-1997), personi tjetër i lidhur A. M. kishte mundësi të kursente shumën 443.786 lekë²¹, ndërsa

²¹ Analiza e Kolegjit për të ardhurat e personit tjetër të lidhur për periudhën 1996-1997 dhe për periudhën qershor 2001 - korrik 2003, është si vijon:

Të ardhura në shumën 614.692 lekë, të përfituara nga punësimi:

- agjent doganor pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën 1996-1997, në shumën 120.000 lekë;

për periudhën gusht 2003 - mars 2004, nga analiza, u konstatua se mundësia e kursimit ishte në shumën 226.653 lekë²².

16.15. Në drejtim të analizës së të ardhurave të huadhënësit A. M., në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në referim të rrethanave specifike të rastit të cilat lidhen me të gjitha elementet e arsyetuara më lart, duke nisur nga saktësia e koherenca e deklarimeve, si edhe nga të dhënat e dokumentuara që krijojnë bindjen për marrëdhëniet e punësimit dhe krijimin e të ardhurave prej personit tjetër të lidhur, kohën e largët të krijimit të kësaj marrëdhënieje, që përkon me fillimet e zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, Kolegji vlerëson si të drejtë pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizë të ardhurat e huadhënësit A. M., për të cilat nga hetimi administrativ janë administruar të dhëna që faktojnë shlyerjen e detyrimeve tatimore, të cilat u përkasin shumave të përfituara nga punësimi i huadhënësit në shoqërinë “{***}” ShPK në vitet 1996-1997, si dhe pranë ndërmarrjes Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë, për periudhën qershor 2001 - mars 2004, në total në shumën 670.439 lekë.

16.16. Për sa më sipër, Kolegji, në ndryshim nga Komisioni, njohu dhe llogariti si burime për krijimin e shumës së dhënë hua, të ardhurat e krijuara prej tij e që përmbushin kriteret e parashikuara nga neni D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, nga neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, duke përcaktuar shumën e cila do të përfshihet si e ardhur e ligjshme në analizën financiare që kryhet për kontrollin e burimeve, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht se Kolegji nuk konsideroi si të ardhur të ligjshme në këtë analizë, të ardhurat e pretenduara nga punësimi i personit tjetër të lidhur në tragetin “{***}” të linjës Sarandë – Korfuz - Sarandë në vitet 1998-2001, mori në analizë dhe vlerësoi objektivisht peshën e këtij qëndrimi, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, duke mbajtur në konsideratë specifikën e rastit, boshllëkun ligjor për këtë lloj marrëdhënieje specifike punësimi në kohën e krijimit të saj, si edhe evidentimin e disa të dhënave që japin informacion domethënës për ekzistencën e saj.

- 17.** Lidhur me shkakun tjetër të ankimit, nëpërmjet të cilit: *subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit për huan e marrë nga personi tjetër i lidhur Gj. D.*²³, në vitet 2002-2003, në shumën 1.700.000 lekë, të përdorura pjesërisht si burim krijimi për ndërtimin e objektit 1+1 kate në Sarandë, si dhe për blerjen e apartamentit me sip. 54 m² në Sarandë, duke pretenduar se shuma e marrë hua nga ky huadhënës është krijuar me burime të ligjshme prej aktivitetit tregtar, si dhe nga paga e përfutuar për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore, Kolegji analizon sa vijon.

17.1. Lidhur me huan e marrë prej subjektit nga shtetasi Gj. D., në vendimin e Komisionit është konkluduar se: [...] *Trupi gjykues, në vlerësim të dokumentacionit të administruar për të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë “{***}” ShPK, ka konstatuar se referuar kartelave të tatimit mbi të ardhurat për shoqërinë “{***}” ShPK, me administrator z. Gj. D., me nr. NIPTI {***}, jepen të dhëna për përcaktimin e detyrimit mbi të ardhurat dhe pagesat dhe gjithashtu, deri në*

-
- *punësimi pranë ndërmarrjes Ujësjetllës-Kanalizime, Sarandë, për periudhën qershor – dhjetor 2001 në shumën 112.548 lekë, për vitin 2002 në shumën 277.136 lekë, për periudhën janar – korrik 2003 në shumën 225.008 lekë.*

Shpenzime jetese në shumën 211.706 lekë, të përlllogaritura sipas metodologjisë së Kolegjit (në masën 66% të të ardhurave për periudhën 1996-1997 dhe sipas të dhënave të INSTAT-it për vitet 2000 e në vazhdim).

Mundësi kursimi në shumën 443.786 lekë.

²² *Analiza e Kolegjit për të ardhurat e personit tjetër të lidhur për periudhën gusht 2003 - mars 2004, është si vijon:*

Të ardhura nga punësimi në shumën 289.296 lekë.

Shpenzime jetese në shumën 62.643 lekë (të përlllogaritura sipas të dhënave të INSTAT-it).

Mundësi kursimi në shumën 226.653 lekë.

²³ *Në aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, por edhe në vendimin e Komisionit, ky shtetas rezulton herë si Gj. D. e herë si Gj. D..*

vitin 1998, konfirmohen pagesat e tatimit, por ndërkohë konstatohet se çelja e vitit 2002, është bërë me minus. Po ashtu, në analizë të të dhënave të marra nga ISSH-ja, Dega e Sigurimeve Sarandë, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2020, informohet se shoqëria “[***]” ShPK ka depozituar listëpagesa për periudhën mars 1995 dhe për periudhën maj – dhjetor 1995, periudhë kjo që nuk mund të sigurojë të ardhura të mjaftueshme edhe sikur Komisioni të përlllogarisë pagën maksimale, sipas legjislacionit të kohës. [...] Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk provoi se ishte në pamundësi objektive për të zotëruar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e huadhënies që ka shërbyer si burim krijimi i pasurisë, për shkak se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit për të provuar ligjshmërinë e huas së marrë, në shumën 1.700.000 lekë, nga shtetasi Gj. D., kanë mbetur në nivel deklarativ dhe jo të provuar, sipas kërkesave të pikës 3 të nenit D të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

17.2. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me huan e marrë nga z. Gj. D., pretendon se konkluzioni i Komisionit është bazuar në një përcaktim të gabuar të faktit, të ardhur për shkak të një shqyrtimi jo të plotë e tërësor të provave të administruara për këtë çështje. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se prej Komisionit, provat e siguruara nga organet tatimore që japin të dhëna për të ardhurat e shtetasit Gj. D. dhe bashkëshortes së tij, janë vlerësuar në mënyrë të shkëputur, duke shmangur vlerësimin e tyre në tërësi, bashkë me provat që vërtetojnë se të njëjtat organe tatimore (DRT Sarandë) konfirmojnë zyrtarisht se nuk disponojnë dokumentacionin justifikues tatimor të kërkuar nga shtetasi Gj. D., për shkak të dëmtimit të këtyre dokumenteve. Subjekti potencon pretendimin se me dokumentacionin e administruar përgjatë hetimit administrativ, ai ka mundur të provojë ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave nga huadhënësi, me burim nga aktiviteti tregtar dhe si person fizik, duke kërkuar nga Kolegji që, në vlerësimin e kësaj huaje, të konsiderojë faktin se në kohën kur është marrë pjesa më e madhe e saj (1.300.000 lekë), pra në vitin 2002, nuk ishte miratuar ende ligji nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”)²⁴. Në këtë kuptim, subjekti arsyeton se në kohën e marrjes së kësaj huaje, nuk kishte asnjë detyrim për të deklaruar as të ardhurat, as burimin e krijimit të tyre dhe as të kujdesej nëse për shumën e marrë hua, huadhënësi kishte shlyer detyrimet tatimore.

17.3. Lidhur me këtë marrëdhënie, së pari Kolegji e gjen me vend të përshkruajë edhe në këtë rast, konstatimet që ka bërë lidhur me mënyrën e deklarimit të kësaj marrëdhënieje prej subjektit të rivlerësimit, deklarime të cilat i kanë dhënë shtetasit Gj. D., statusin e personit tjetër të lidhur në kuptim të neneve 3, pika 14 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Rezulton se subjekti e ka deklaruar faktin e marrjes hua prej këtij shtetasi në deklaratën *vetting*, në të cilën ka deklaruar për këtë shtetas në rubrikën e personave të tjerë të lidhur, për shkak të marrjes së një huaje në vitet 2002-2003, të shlyer plotësisht. Ai ka deklaruar që në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, huan e marrë prej shtetasit Gj. D. në vlerën prej 1.700.000 lekësh, e cila ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament të ndodhur në Sarandë dhe si një prej burimeve të financimit për ndërtimin e objektit 1+1, të ndodhur në Sarandë. Përgjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se personi tjetër i lidhur i ka dhënë atij shumën prej 1.300.000 lekësh në vitin 2002 dhe diferencën prej 400.000 lekësh në vitin 2003. Në vijim, në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar për shlyerjen e një pjese të huas dhe ka dhënë në fund të fletës në të cilën gjendet rubrika e detyrimeve financiare, numrin e telefonit të personit tjetër të lidhur, me qëllim ofrimin ndaj institucionit për verifikimin e tij. Në DPV-të e viteve 2005 e 2006, ka deklaruar shlyerje të kësaj huaje të likuiduar krejtësisht. Në përgjigjet e dhëna ndaj pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se shtetasi Gj. D. ka pasur dhe ka aktivitet privat në fushën e prodhimit të brumit dhe pastiçerisë, të zhvilluar nga dy subjekte tregtare në

²⁴ Miratuar më datë 10.4.2003.

pronësi të tij, “{***}” ShPK, me NIPT {***}, dhe Gj. D., person fizik me NIPT {***}. Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur si provë deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.02.2007, të lidhur midis tij dhe shtetasit Gj. D.. Në këtë deklaratë të mbajtur në vitin 2007, jashtë kontekstit të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe huadhënësi saktësojnë kthimin prej subjektit të këstit të fundit të sasisë së papaguar të huas së marrë. Kolegji konstaton se subjekti ka deklaruar në mënyrë shteruese e koherente zhvillimet e kësaj marrëdhënieje, që në fillesat e saj derisa ajo ka përfunduar efektet e veta, si edhe e ka risjellë atë të saktë e të plotë edhe në deklaratën *vetting*, duke demonstruar kujdesin e duhur për plotësimin e kërkesave të ligjit dhe realizimin e deklarimeve transparente e të singerta.

17.4. Lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të kësaj shume prej personit tjetër të lidhur Gj. D., Kolegji shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, nga të cilat përftohen informacionet që lidhen me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar, si edhe ato të krijuara nga pagat për të cilat janë paguar sigurimet shoqërore. Subjekti ka pretenduar gjithashtu edhe të ardhura të krijuara nga shitja e një pjese të aksioneve të bashkëshortes së personit tjetër të lidhur, të cilat duhen konsideruar në vlerësimin e përgjithshëm që i bëhet aftësisë së tyre për të krijuar e kursyer.

17.5. Kolegji, me qëllim analizimin e situatës financiare të personit tjetër të lidhur, mori në shqyrtim aktet administruara gjatë hetimit, nga të cilat rezultojnë të dhënat lidhur me aktivitetin tregtar të tij si në vijim.

1) Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “{***}” ShPK në QKB, rezulton se ajo është themeluar në vitin 1994, dhe vazhdon aktivitetin pa asnjë pezullim të regjistruar në regjistrë gjatë gjithë periudhës e aktualisht.

2) Shkresa nr. {***} prot., datë 14.02.2020, e Bashkisë Sarandë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila konfirmon se z. Gj. D., nëpërmjet subjektit tregtar “{***}” ShPK, me NIPT {***} dhe subjektit fizik Gj. D., me NIPT {***}, i regjistruar datë 01.01.2003, ka ushtruar aktivitet në prodhimin dhe tregtimin e nënprodukteve të brumit dhe ëmbëlsirave, si dhe tregtimit të artikujve me pakicë dhe shumicë duke filluar nga viti 1994 e në vazhdim.

3) Shkresa nr. {***}²⁵ prot., datë 09.05.2019, nga DRT Sarandë, në të cilën konfirmohet fitimi i realizuar nga shoqëria “{***}” ShPK, në vitin 1994²⁶, në shumën 6.994 lekë dhe për vitin 1995²⁷ në shumën 122.739 lekë. Në shkresë gjithashtu është konfirmuar se për shoqërinë “{***}” ShPK, për vitet e tjera nuk disponojnë pasqyra financiare, ndërsa për biznesin e personit fizik Gj. D. informohet se nuk ka të dhëna për këtë periudhë.

4) Shkresa nr. {***}, datë 06.02.2020, e DRT Sarandë, sipas së cilës arkiva e këtij institucioni ka gjetur dokumentacion lidhur me përcaktimet e detyrimit të tatimit mbi të ardhurat për vitet 1995-1998 dhe pagesa të këtij tatimi në këto vite për shoqërinë “{***}” ShPK. Shkresa informon gjithashtu se në dosjen ku janë arkivuar kartelat e tatim fitimit për vitin 2003, është dhe emri Gj. D., por kartela e tatimit mbi të ardhurat nuk ishte fizikisht.

5) Shkresa nr. {***}, datë 13.05.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilën konfirmohet se: i) personi Fizik Gj. D. është regjistruar në këto organe më datë 01.01.2003 si person fizik dhe të dhënat që disponohen rezultojnë pas vitit 2009, periudhë e cila nuk

²⁵ Bashkëlidhur me shkresën është dhe bilanci i viti 1994, në të cilin rezulton se për këtë vit shoqëria “{***}” ka marrë hua nga bankat dhe institutet e kreditimit shumën 2.000.000 lekë, e cila është e pozicionuar në pasivin e pasqyrave financiare. Gjithashtu, në tabelën e emërtuar “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave, konstatohet që numri i të punësuarve për vitin 1994, është 7 të punësuar gjithsej në fund të vitit.

²⁶ Për vitin 1994, paga të paguara në shumën 28.000 lekë.

²⁷ Për vitin 1995, paga të paguara në shumën 145.600 lekë.

korrespondon me dhënien e huas; ii) subjekti “{***}”²⁸, me nr. NIPTI {***}, është regjistruar në këtë organ më datë 01.07.1996, por në sistemin c@ts nuk ka informacion.

6) Praktika e sjellë nga OTP Bank me shkresën nr. {***} prot., datë 22.05.2019, bashkëlidhur së cilës gjendet vërtetimi i lëshuar nga DRT Sarandë, i datës 17.12.2003, në të cilin pasqyrohet se: *Vërtetojmë se z. Gj. D. është i regjistruar pranë Degës së Tatim Taksave Sarandë me nr. NIPT {***} dhe nr. certifikate {***} dhe nuk ka detyrime tatimore.*

7) Shkresa nr. {***} prot., datë 14.02.2020, lëshuar nga DRT Sarandë, e cila informon se në lidhje me dokumentacionin për të cilin shtetasi Gj. D. është regjistruar në librat e protokollit të DRT Sarandë: *nuk mundemi të gjejmë dokumente të tjera justifikuese pasi nga transferimi i ambienteve të DRT Sarandë, nga viti 1993 deri më 2007, DRT Sarandë ka ndryshuar disa herë vendndodhje, ndoshta këto dokumente justifikuese mund të jenë dëmtuar gjatë transferimit të dosjeve të arshivës.*

Në drejtim të provueshmërisë së pagave të përfituara prej personit të lidhur dhe bashkëshortes së tij në periudhën në fjalë, Kolegji analizoi aktet e administruara gjatë hetimit, nga të cilat kanë rezultuar të dhënat e mëposhtme.

1) Vërtetimi nr. {***}, datë 29.01.2020, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Sigurimeve Sarandë (në vijim “ISSh Sarandë”) në të cilin konstatohen se nga Gj. D. si Person Fizik, janë paguar sigurime shoqërore²⁹.

2) Vërtetimi nr. {***}, datë 28.01.2020, lëshuar nga ISSh Sarandë, sipas të cilit, “{***}” ShPK ka dorëzuar listëpagesa për periudhën mars 1995 dhe për periudhën maj – dhjetor 1995, nga të cilat rezulton se vlera e pagës së z. Gj. D. dhe e bashkëshortes T. D., për vitin 1995, është në shumën 45.181 lekë.

3) Vërtetimi nr. {***}, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Sarandë (pjesë e praktikës së marrë nga banka OTP), në të cilin pasqyrohet se: *Z. Gj. D. është i siguruar për periudhën 01.01.2001 - 31.12.2004.* Në mungesë të vlerave të përcaktuara në këtë dokument, referuar përmbajtjes së tij, u konsiderua se është përfituar paga minimale për periudhat e siguruar, nga përllogaritja e së cilës rezultoi se Gj. D. kishte përfituar në total, pagë në shumën prej 61.440 lekësh.

4) Vërtetimi nr. {***} prot., datë 12.02.2020, lëshuar nga ISSh Sarandë, sipas të cilit, T. D. ka paguar sigurimet shoqërore si e punësuar te shoqëria “{***}” ShPK³⁰ dhe si *person fizik*³¹. Në mungesë të vlerave të përcaktuara në këtë dokument, referuar përmbajtjes së tij, u konsiderua se është përfituar paga minimale për periudhat e siguruar, nga përllogaritja e së cilës rezultoi se znj. T. D. kishte përfituar në total, pagë në shumën prej 324.421 lekësh.

17.6. Në analizë të kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar metodologjisë së aplikuar nga Komisioni në analizën financiare të kryer për personin tjetër të lidhur Gj. D., bazuar në informacionin që jepet nga deklaratimet periodike dhe dokumentacioni i administratës tatimore dhe i sigurimeve shoqërore, si dhe ai bankar³² për këtë huadhënës, Kolegji, duke vlerësuar elementet e mësipërme në harmoni me njëri-tjetrin, çmoi se personi tjetër i lidhur duhet t’i nënshtrohet një kontrolli të arsyeshëm të burimeve të krijimit të shumës prej 1.700.000 lekësh. Në këtë analizë, Kolegji mban parasysh: **i)** faktin që subjekti i rivlerësimit, huan e marrë nga huadhënësi Gj. D., e ka marrë në vitet 2002 dhe 2003, në një kohë që përkon të jetë para dhe sapo ka hyrë në fuqi ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarin dhe kontrollin e*

²⁸ Në dosjen e subjektit tatimor me emër tregtar “{***}”, janë dokumentet si në vijim: akti i themelit të shoqërisë “{***}”, statuti i shoqërisë dhe pasqyra financiare e vitit 1994.

²⁹ Për periudhat 01.12.1992 - 30.09.1993; 01.07.1998 - 30.06.1999; 01.01.01 - 30.06.2001.

³⁰ Për periudhat 01.03.1995 - 31.03.1996; 01.05.1995 - 31.12.1995.

³¹ Për periudhat 01.07.1998 - 30.06.1999; 01.01.2001 - 31.03.2005; 1.10.2008 - 31.12.2008; 01.04.2009 - 30.09.2009; 01.01.2010 - 31.12.2011.

³² Vërtetimi i datës 17.12.2003, i DRT Taksave Sarandë, bashkëlidhur me praktikën e OTP Bank, shprehet se Gj. D., i regjistruar pranë Degës së Tatim Taksave Sarandë, me NIPT {***}, nuk ka detyrime tatimore.

pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, rrethanë që relativizon objektivisht përgjegjësinë e subjektit për të pasur kujdesin e dhuruar në raport me përcaktimet që solli ligji nr. 9049/2003 për personat e tjerë të lidhur e aq më shumë ligji nr. 84/2016. Në kohën e krijimit të kësaj marrëdhënieje, nuk rezulton që subjekti duhej të kishte vëmendje të shtuar rreth verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurave të huadhënësit në konceptin që ligji nr. 84/2016 përcaktoi për të. Konstatimi i një aktiviteti tregtar që ushtrohej prej vitesh, duket se ishte i mjaftueshëm si kriter për të krijuar besim rreth ligjshmërisë së të ardhurave nën një optikë sipas një standardi të përgjithshëm; **ii**) faktin që pranohet nga përmbajtja e secilit akt, që personi i lidhur dhe shoqëria në të cilën ai ishte ortak, ka ushtruar aktivitet pa ndërprerje për gjithë periudhën 1994 deri në vitin 2003, por edhe në vazhdim, që tregon për stabilitet e një veprimtari gjithësesi të suksesshme; **iii**) faktin që ndonëse organet tatimore referojnë fitim të përcaktuar për periudhën 1994-1998, dhe nuk disponojnë të dhëna dhe as evidentojnë ndërkohë që subjekti tregtar të ketë pasur ndonjë detyrim tatimor të pashlyer; **iv**) faktin që në vitin 2003, organet tatimore certifikojnë për efekt të plotësimit të dokumentacionit bankar, mospasjen e detyrimeve tatimore për personin fizik Gj. D., duke dhënë indicie për një situatë të paktën pa të tilla detyrime në drejtim të shoqërisë “{***}”, në të cilën ky shtetas ishte ortak, situatë e cila mund të ishte bërë prezent nëse do të kishte ekzistuar; **v**) faktin që aktet e sjella nga organet tatimore për të pasqyruar fitimin e llogaritur të shoqërisë, konstatohet se kanë kundërshti që vënë në dyshim saktësinë e përlllogaritjeve³³; **vi**) faktin që vetë organet tatimore justifikojnë mospasjen e të dhënave me mundësinë dëmtimit/humbjes së akteve shkresore për shkak të lëvizjeve të zyrave vendore deri në vitin 2007.

17.7. Mbështetur në arsyet e mësipërme, Kolegji analizoi fitimin e mundshëm/hipotetik të subjektit tregtar “{***}” ShPK për periudhën 1996-2003, sipas një metodologjie logjike e aritmetike, e cila u ndërtua mbi marzhin e rritjes së fitimit për këtë subjekt për vitet 1994 e 1995, për të cilat ka të dhëna nga organet tatimore³⁴ sipas kësaj metodologjie, mbështetur në të dhënat e përfutuara nga aktet e administruara, rezultoi se fitimi potencial i subjektit tregtar për këtë periudhë, ishte në vlerën 1.970.818 lekë.

17.8. Kolegji vlerësoi se në të ardhurat e konsideruara për personin tjetër të lidhur do të duhej të përfshihen edhe pagat e përfutuara prej tyre referuar të dhënave që përmbajnë aktet e sigurimeve shoqërore. Kolegji përdori referimin në pagën minimale në periudhën respektive, në ato raste kur nga vërtetimet e sigurimeve shoqërore, nuk kishte të dhëna për pagën por vetëm për vlerën e kontributit, duke kryer një përlllogaritje në nivelin minimal sipas legjislacionit të kohës, për të ardhurat e tyre nga pagat. Sipas vlerësimit të bërë në Kolegji lidhur me këto të ardhura sipas metodologjisë së cituar, rezultoi se bashkëshortët kishin pasur të ardhura nga ky zë në periudhën 1994-2003 në vlerën 1.143.940 lekë³⁵.

³³ Bazuar në praktikën e DRT Sarandë, me shkresat nr. {***} prot., datë 09.05.2019, nr. {***} prot., datë 30.04.2019 dhe nr. {***} prot., datë 19.04.2019, bashkëlidhur së cilës janë edhe disa kartela për përlllogaritje të tatimit fitimit të shoqërisë “{***}” ShPK, që janë evidenca/dokumente pune të mbajtura me shkrim dore nga punonjësi i administratës tatimore (te të cilat janë përcaktuar disa detyrime tatimore, dhe krahu tyre janë evidentuar shlyerje pjesore të këtyre detyrimeve) dhe jo në të dhënat e pasqyrave financiare.

³⁴ Përlllogaritja e subjektit për fitimin nga aktiviteti i shoqërisë “{***}”, mbështetur në raportin e fitimit të vitit 1994 me atë të vitit 1995, i cili rezulton me rreth 2,92 herë më i madh, është një përlllogaritje e arsyeshme e cila mbështetet dhe nga një dokument tjetër i gjendur bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 06.02.2020, lëshuar nga DRT Sarandë. Dokumenti ka të bëjë me “Planin e biznesit” të subjektit “{***}”, të dorëzuar pranë organeve tatimore në lidhje me parashikimin e realizimit në 6-mujorin e dytë të vitit 1998. Nga plani i biznesit, konstatohet që fitimi i parashikuar është në masën 150.000 lekë dhe tatimi i përlllogaritur në masën 30% të fitimit (45.000 lekë). Fitimi për vitin 1998, parashikohej rreth 300.000 lekë.

³⁵ Shuma prej 1.143.940 lekësh përfaqëson shumën totale të pagave minimale të përfutuara nga Gj. dhe T. D. për periudhën 1994 - qershor 2003. Në kompozimin e kësaj shume, u përdorën të dhënat e rezultuara nga pasqyrat financiare të shoqërisë “{***}” për pagat e paguara në masën 8.000 lekë në vitin 1994 dhe 58.000 lekë në vitin 1995. Për periudhën në vazhdim, u morën të dhënat e rezultuara nga vërtetimet e lëshuara nga Sigurimet Shoqërore për pagën minimale të përfutur nga dy të punësuarit, duke i shtrirë këto vlera për të gjithë periudhën

17.9. Kolegji konsideroi edhe shpenzimet për jetesë të dy bashkëshortëve në raport dhe të periudhës që ata figuronin të kishin përfituar paga sipas vërtetimeve, shpenzime të cilat rezultuan të jenë në vlerën 1.775.590 lekë.

17.10. Sipas analizës financiare të kryer në Kolegji mbi të dhënat e mësipërme, rezultoi se personi tjetër i lidhur kishte mundësi të kursente nga të ardhurat e krijuara me burime të ligjshme, shumë prej 1.339.168 lekësh, shumë e cila u vlerësua se plotëson në mënyrë të arsyeshme kriteret e së ardhurës të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 284/016 e, për pasojë, duhet të njihet dhe llogaritet si e tillë në analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të subjektit për financimin e pasurive për të cilat ai ka deklaruar përdorimin e huas si burim. Kolegji nuk konsideroi në këtë analizë efektin e kredive bankare të marra prej shoqërisë “{***}” ShPK, të cilat u vlerësuan se kanë ndikim në bilancet e shoqërisë dhe jo të ortakut Gj. D.. Gjithashtu, Kolegji nuk mori në analizë të ardhurat e krijuara prej shitjes së një pjese të pasurisë së paluajtshme së bashkëshortes së personit tjetër të lidhur, znj. T. D., si dhe një transaksion për rregullim të llogarive me shtetasen P. D., veprime të cilat³⁶ subjekti nuk i kishte referuar si burim të ardhurash. Pavarësisht, Kolegji e mban në konsideratë këtë fakt në vlerësimin tërësor të mundësisë së personit të lidhur, si një nga arsyet për të cilat analiza e mësipërme u konceptua si e tillë

17.11. Në përfundim për huan e marrë nga personi tjetër i lidhur, z. Gj. D., në vitet 2002 dhe 2003, në shumën totale 1.700.000 lekë, Kolegji, në ndryshim nga Komisioni, njohu dhe llogariti si të ardhura të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, jo vetëm të ardhurat e dokumentuara prej organeve tatimore e sigurimeve shoqërore për periudhën 1994 - 2003, por për llogariti një fitim të mundshëm, të realizuar prej subjektit tregtar, bazuar në të dhënat e marra prej organeve shtetërore, si: **(i)** aktiviteti ka vazhduar prej vitit 1994 pa ndërprerje; **(ii)** subjekti tregtar nuk ka pasur detyrime tatimore të pashlyera në vitin 2003; **(iii)** organet tatimore paraqesin mundësinë e humbjes/dëmtimit të dokumentacionit, për shkak të lëvizjes disa herë të ambienteve ku kanë ushtruar funksionet organet tatimore rajonale; **(iv)** si edhe në fitimin e realizuar e të deklaruar nga subjekti tregtar në vitet paraardhëse. Në konkluzion të kësaj analize, u përfshi si e ardhur e ligjshme e përfituar prej kësaj marrëdhënieje huaje, vetëm shuma që rezultoi nga përlllogaritja financiare e kryer mbi metodologjinë e përshkruar më lart, e cila, në vlerësimin e Kolegjit, konsideruar dhe deklarimet me saktësi e plotësi të kësaj marrëdhënieje huaje që në deklaratën fillestare e në vijim, si dhe duke konsideruar edhe faktin që në pjesën më të madhe të saj, kjo hua është marrë para miratimit të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), plotësoi kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për t’u njohur si një e ardhur e ligjshme.

- 18.** *Lidhur me shkaktun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit ai pretendon se janë tërësisht të pabazuara konkluzionet e Komisionit se subjekti nuk arriti të provojë bindshëm dhe me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 850.000 lekë, të krijuar nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore prej bashkëshortes së tij deri në fund të vitit 2004, Kolegji analizon si vijon.*

dhe duke zbritur prej tyre detyrimin për sigurime shoqërore në masën 11,2% të pagës minimale. Kjo përlllogaritje rezultoi për të dy të punësuarit në shumën totale prej 1.077.940 lekësh për periudhën 1996 - qershor 2003, e cila së bashku me shumën e konfirmuara nga pasqyrat financiare të viteve 1994-1995, rezultoi në një shumë akumulative prej 1.143.940 lekësh.

³⁶ *Shitje e pasurisë së paluajtshme nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.12.1994 dhe aktit të hipotekimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.1994, prej të cilave T. D. kishte përfituar shumën 1.888.640 lekë, si dhe të ardhura të tjera të përfituara nëpërmjet rregullimit të llogarive të bashkëpronësisë me shtetasen P. D., në shumën 765.600 lekë.*

18.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me të ardhurat nga mësimdhënia e bashkëshortes së subjektit, konstatohet se janë mbajtur dy qëndrime, njëri që lidhet me deklarimin e tyre dhe tjetri që lidhet me provueshmërinë e kërkesave të ligjit për të ardhurën e ligjshme. Për sa i përket deklarimit të këtyre të ardhurave prej subjektit, Komisioni ka konkluduar se: *Fillimisht është konstatuar se në vitin 2004, subjekti ka deklaruar të ardhura të kësaj natyre vetëm në shumën 140.000 lekë. Në këto kushte, presupozohet se diferenca e shumës së pretenduar i përket periudhës përpara vitit 2004, sikurse edhe subjekti ka pretenduar. Megjithatë, duke i qëndruar pretendimit të subjektit që në shumën e deklaruar në vitin 2003, bën pjesë edhe e ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes, trupi gjykues sërish konstaton se për sa kohë në deklarimin e formularit likuiditete, në depozitat e bashkëshortes së subjektit nuk citohet si burim krijimi edhe mësimdhënia nga kurset jashtëshkollore, atëherë pretendimi i shumës së të ardhurave nga kjo veprimtari, për këtë periudhë, mbetet tërësisht në nivel deklarativ. [...]*

18.2. Për sa u përket kriterëve të ligjit për të ardhurën e ligjshme, si konkluzion përfundimtar për trajtimin e tyre, Komisioni ka konkluduar se: *Pikërisht, pagesa e detyrimit tatimor vetëm pas plotësimit të deklaratës “vetting”, për sa kohë ato deklarohen si burim krijimi në një pasuri dhe impaktojnë analizën financiare në përllogaritje, vlerësohet se nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe parashikimet e udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi mosdeklarimi i tyre në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit. [...] Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm dhe me dokumentacion ligjor, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 850.000 lekë, krijuar nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore, nga bashkëshortja e subjektit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me këto të ardhura të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie.*

18.3. Në ankim, lidhur me të ardhurat e krijuara nga mësimdhënia jashtëshkollore e bashkëshortes, subjekti pretendon për krijimin e këtyre të ardhurave nga bashkëshortja (para martesë), si dhe identifikon llogaritë bankare që janë furnizuar me këto të ardhura, duke pretenduar se:

- i.* Mosdeklarimi i një pjese të këtyre të ardhurave në DPV fillestare të vitit 2003, kur ndërkohë subjekti i ka deklaruar ato në deklaratën *vetting* dhe si burim krijimi pasurish në deklaratën fillestare, nuk e vendos atë në kushtet e një deklarimi të pasaktë. Subjekti pretendon se Komisioni nuk mund të zbatojë në mënyrë prapavepruese Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke vendosur masë disiplinore për deklarimet në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003.
- ii.* Pagimi i detyrimeve tatimore në vitin 2018, në periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, por para fillimit të procesit të tij të rivlerësimit, e vendos atë në kushtet e mospasjes së detyrimeve tatimore lidhur me këtë të ardhur.
- iii.* Sigurimi i dokumenteve justifikuese për këto të ardhura, është një pamundësi objektive e subjektit, e shkaktuar si për shkak të natyrës së punës së kryer nga bashkëshortja (mësimdhënie/kurse private), por edhe për shkak të kohës së largët që ka kaluar nga krijimi i tyre.

18.4. Kolegji, në funksion të kontrollit të deklarimeve të subjektit për këto të ardhura, konstatoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Angazhime në veprimtari

private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, ndër të tjera, edhe shumën prej 850.000 lekësh, si të ardhura të krijuara nga puna e bashkëshortes S. M., nga kurset e matematikës në periudhën 1997-2004. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, subjekti ka përfshirë këtë zë në burimet e krijimit të pasurive që ai ka pasur në atë moment. Ai deklaroi burimet e financimit të apartamentit prej 54 m² të ndodhur në Sarandë: *Të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhura të kësaj të fundit të krijuara para martesë*, si edhe i përfshin ato si burim krijimi të pasurive likuiditet, të cilat ndodhen në gjendje depozite bankare në momentin e deklarimit fillestar. Në DPV-2004, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga kurset e organizuara nga bashkëshortja në muajt janar - mars 2004, në vlerën 140.000 lekë, kurset janë të organizuara privatisht nga bashkëshortja jashtë punës në Sarandë*.

18.5. Nga analiza e këtyre deklaratave, Kolegji vlerëson se subjekti ka deklarime të plota rreth të ardhurave të krijuara nga kurset e mësimdhënies. Së pari, ai rezultoi t'i ketë deklaruar qartësisht në deklaratën *vetting* sipas detyrimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke përjashtuar në këtë mënyrë ndonjë konkluzion të mundshëm për pasaktësi në deklarime. Fakti i deklarimit të tyre në deklaratën që i nënshtrohet kontrollit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, dhe identifikimi i saktë i tyre qoftë në vlerë, qoftë edhe në burimin e krijimit, ezauron përmbushjen e kërkesave të ligjit lidhur me detyrimet për deklarim. Në këtë kuptim, Kolegji e gjen të pabazuar qëndrimin e konkluzionin se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë në këtë drejtim.

18.6. Së dyti, për sa u përket detyrimeve të subjektit prej ligjit nr. 9049/2003, sërish Kolegji konstaton se ai ka bërë deklarimet e tij dhe ka lënë gjurmë për ekzistencën e këtyre të ardhurave. Nga leximi i deklaratave periodike, 2003 e 2004, konstatohet se subjekti ka deklaruar krijimin e shumës prej 140.000 lekësh nga kurset private të bashkëshortes në vitin 2004, deklaruar si e ardhur në këtë deklaratë. Për pasojë, diferenca prej 710.000 lekësh (850.000 lekë deklaruar në deklaratën *vetting*, në total – 140.000 lekë, deklaruar si të krijuara në vitin 2004), rezultoi të jetë krijuar deri në fund të vitit 2003. Përveç këtij elementi, nga leximi i deklaratës fillestare të pasurisë, kuptojmë që kjo vlerë ka shërbyer për financimin e pasurive të krijuara deri në atë moment, apartament, dhe kryesisht depozita bankare të cilat janë deklaruar në këtë deklaratë.

18.7. Në këto kushte, analiza e Kolegjit lidhur me këto pretendime të subjektit, u fokusua në drejtim të provueshmërisë së krijimit të këtyre të ardhurave dhe plotësimit të kriterëve të parashikuara prej nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me ligjshmërinë e tyre.

18.8. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së këtyre të ardhurave, Kolegji mori në shqyrtim të dhënat bankare të kohës. Kolegji konsideroi si të argumentuar pretendimin e subjektit se nga shuma 850.000 lekë, e deklaruar si e përfituar në tërësi nga personi i lidhur nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore, duhej zbritur shuma 140.000 lekë, e deklaruar/specifikuar si e përfituar nga këto kurse nga subjekti në DVP-në e vitit 2004. Në këto kushte, analiza e Kolegjit u përqendrua për të evidentuar nëse për shumën e mbetur, 710.000 lekë, ekzistonin gjurmë/të dhëna të kohës që provonin krijimin e tyre, për të provuar vërtetësinë e deklarimeve në deklaratën *vetting*, por edhe deklarimet në DVP-në e vitit 2004, për identifikimin e tyre si burim i krijimit të pasurive.

18.9. Nga analiza e kryer, Kolegji konstatoi se bashkëshortja e subjektit, në periudhën para martesës³⁷, kishte pasur lëvizje bankare. Konkretisht, nga *statement*-i i lëshuar nga Tirana Bank, i cili gjendet i administruar në fashikull, rezultoi se bashkëshortja kishte çelur pranë kësaj banke më datë 26.01.2001, një depozitë në shumën 1.898 USD, me burim krijimi “dhurim nga të afërmit”, e cila deri më 31.12.2001, ka qenë me gjendje 6.062,77 USD. Kjo depozitë në

³⁷ Data e martesës së subjektit të rivlerësimit është 01.07.2002.

vitin 2003 është zvogëluar dhe subjekti gjendjen e saj, në vlerën 4.000 USD, e ka deklaruar në DVP-në e vitit 2003, me përshkrimin: *dhuruar nga familjarët e bashkëshortes dhe nga puna e saj*. Sipas të dhënave të marra gjatë hetimit administrativ nga Tirana Bank, rezulton se S. M., bashkëshortja e subjektit, më datë 30.11.2001, kishte të depozituar në total (*pa marrë në konsideratë shumën e dhuruar prej të afërmeve prej 1.898 USD*), shumën 240.000 lekë dhe 4.102 USD, në total 240.000 lekë + (4.102 USD x 143,6 lekë) = 829.047 lekë.

18.10. Kolegji ka vlerësuar për këtë periudhë edhe të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja e subjektit në vitet 1997 - nëntor 2001, si mësuese në shkollën publike “{***}”, Sarandë, për të pasur një panoramë të plotë dhe për të identifikuar shumën që ka gjeneruar në të ardhurat e bashkëshortes, mësimdhënia nga kurset private. Sipas kësaj analize, rezulton se të ardhurat nga punësimi në shkollën publike “{***}”, janë në masën 542.632 lekë, të cilave, nëse u zbriten shpenzimet e jetesës të përlllogaritura sipas metodologjisë së Komisionit, në shumën 342.000 lekë, evidentohet shuma e mundshme që bashkëshortja mund të kishte krijuar si kursim prej këtyre të ardhurave, në vlerën 200.632 lekë.

18.11. Duke analizuar të dhënat bankare të kohës, të përcjella nga Tirana Bank, nga e cila konfirmohet se bashkëshortja e subjektit më datë 30.11.2001, kishte të depozituar shumën totale 829.047 lekë, Kolegji vlerëson se në këtë shumë, vlera 200.632 lekë përfaqëson shumën e krijuar nga paga si arsimitare dhe diferenca e mbetur, në shumën 628.415 lekë, përfaqëson shumën që bashkëshortja e subjektit ka siguruar nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore private. Nga veprimet bankare të bashkëshortes gjen pasqyrim edhe një e dhënë tjetër që ka të bëjë me tërheqjet e shumës 2.000 USD dhe 262.877 lekë, të cilat subjekti i referon se janë përdorur më vonë si burim i krijimit të apartamentit me sip. 54 m² në Sarandë, të deklaruar në DVP-në e vitit 2003 si burim krijimi i kësaj pasurie të identifikuar me përshkrimin si të ardhura të krijuara para martesë.

18.12. Bazuar në analizën e mësipërme, Kolegji konstatoi të provuar me dokumentacion të kohës ekzistencën e të ardhurave të krijuara para martesë nga mësimdhënia jashtëshkollore e bashkëshortes së subjektit.

18.13. Në drejtim të këtyre të ardhurave, çështja tjetër e cila u mor në shqyrtim nga Kolegji i referohet pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me to. Nga vendimi objekt shqyrtimi, konstatohet se pagimi i detyrimeve është bërë pas plotësimit të deklaratë *vetting*, më datë 13.08.2018, fakt që është konsideruar nga Komisioni pa efekt drejt legjitimitimit të këtyre të ardhurave.

18.14. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga mësimdhënia jashtëshkollore e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit në ankim ka kërkuar të konsiderohet fakti që këto të ardhura janë krijuar nga personi i lidhur kur ajo nuk ishte bashkëshorte e subjektit dhe ato datojnë edhe kohë para miratimit të ligjit nr. 9049/2003, i cili përcaktoi për subjektet detyrimin për deklarimin e pasurive dhe të interesave privatë. Gjithashtu subjekti si në Komision, ashtu edhe me ankimin, pretendon se legjislacioni tatimor i kohës nuk parashikonte detyrimin për tatimin e të ardhurave të siguruara nga mësimdhënia jashtëshkollore, pasi në atë kohë ligji nuk parashikonte as formularë për vetëdeklarimin e kësaj të ardhure.

18.15. Lidhur me këtë çështje, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij dhe konkretisht vendimin (JR) 15/2021, tek i cili është arsyetuar se:

Në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur.

18.16. Duke u referuar në këtë qëndrim të mbajtur në jurisprudencën e tij, Kolegji vlerësoi në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga bashkëshortja e subjektit, deri në shumën 628.415 lekë, duke konsideruar *së pari* faktin se ekzistenca e kësaj shume provohet me dokumente bankare të kohës, si dhe *së dyti*, këto të ardhura janë krijuar nga personi i lidhur para martesë, por edhe para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049/2003, mbi të cilin gjyqtarët, si subjekte deklaruese, duhet të deklaronin pasuritë e tyre dhe të bashkëshortëve. Në këto kushte, pagesa me vonesë e tatimit për këto të ardhura të bashkëshortes, të krijuara në kushtet e përshkruara më sipër, u vlerësua nga Kolegji si një vlerë e cila duhet të përfshihet në analizën ekonomike, pasi u konsiderua se nuk mund të penalizohet në mënyrë joproporcionale subjekti i rivlerësimit në kushtet e mësipërme, nëpërmjet mosnjohjes së saj, si një e ardhur e ligjshme.

18.17. Ndërsa Kolegji nuk bëri të njëjtin vlerësim për të ardhurën e deklaruar në vlerën prej 140.000 lekësh në vitin 2004, duke qenë se subjekti nuk provoi bindshëm as krijimin e saj dhe as justifikoi në kuptim të arsytimit orientues të vendimit nr. 15/2021 të Kolegjit, mospagesën në kohë të detyrimeve tatimore në kuptim të ligjit.

- 19.** Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit, nëpërmjet të cilit ai kundërshton si jo të drejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisioni lidhur me shumat e dhuruara bashkëshortes (200.000 dhrahmi greke dhe 1.898 USD) nga familjarët, se aftësia financiare për t'i krijuar dhe ligjshmëria e tyre mbeten në nivel deklarativ, Kolegji analizon si vijon.

19.1. Për shumat e dhuruara bashkëshortes së subjektit nga familjarët, në vendimin e Komisionit është arsyetuar se: [...] *Trupi gjykues e sheh në proporcionalitet vlerësimin e kësaj të ardhure, nga ku, edhe pse ligjshmëria e shumës së dhuruar ka mbetur në nivel deklarativ, konstaton se edhe nëse shumat e dhuruara merren në konsideratë, ato janë në vlera shumë të vogla, duke mos pasjellë kështu ndonjë impakt në analizën financiare të pasurisë, për shkak të balancës negative të rezultuar mbi të ardhura, pasuri dhe detyrime deri në vitin 2003.*

19.2. Lidhur me këtë qëndrim, Kolegji konstaton se pavarësisht se Komisioni referon se e ka vlerësuar me proporcionalitet qëndrimin rreth këtyre të ardhurave të dhuruara nga familjarët, përsëri ato nuk janë përfshirë në analizën ekonomike të Komisionit, duke afektuar negativisht balancën e saj. Për këtë shkak, Kolegji mori në analizë provueshmërinë e ekzistencës dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre në kontekst të rrethanave të rastit.

19.3. Nga deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting*, rezulton se ai ka deklaruar në rubrikën “Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, ndër të tjera: *Shumë e dhuruar bashkëshortes nga familjarët e saj para martesë në vlerën 200.000 drahmi, e barasvlershme me 587 euro; dhe: Shumë e dhuruar bashkëshortes nga familjarët e saj para martesë, në vlerën 1.898 USD.* Lidhur me këto dhurime, subjekti ka deklaruar në DVP-në e vitit 2003, në rubrikën “likuiditete”: *i) depozitë në shumën 200.000 drahmi greke në Bankën e Kursimeve Sarandë. Burim krijimi: dhuruar nga familjarët e bashkëshortes; ii) depozitë në shumën 4.000 USD në “Tirana Bank”. Burim krijimi: dhuruar nga familjarët e bashkëshortes dhe nga puna e saj.* Subjekti ka dhënë shpjegime për këto shuma edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 përgjatë hetimit administrativ, duke potencuar sërish se: *i) shuma 200.000 drahmi, dhuruar bashkëshortes para martesë; ii) shuma 1.898 USD, dhuruar bashkëshortes para martesë.*

19.4. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në fashikull, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka hapur një depozitë në Bankën Tirana, në datën 30.1.2001, në shumën 1.898 USD, ekuivalente me 269.022 lekë³⁸, të cilën subjekti e deklaroi se është dhuruar nga familjarët e saj. Po në këtë datë, bashkëshortja e subjektit ka hapur një depozitë në Bankën e Kursimeve Sarandë, në shumën 200.000 drahmi, ekuivalente me 51.236 lekë³⁹, të cilën subjekti e deklaroi se është dhuruar nga familjarët e saj.

19.5. Kolegji, duke konsideruar se provohet ekzistenca e këtyre shumave që në vitin 2001 sipas dokumentacionit bankar që përputhet edhe me deklarin e subjektit, për sa i përket monedhës dhe vlerave përkatëse, dhe se kjo periudhë përkon me kohën kur bashkëshortja e subjektit nuk e kishte këtë status, referuar kohës së martesës së tyre ligjore më datë 01.07.2002, vlerën modeste të këtyre dhurimeve që përfshihet brenda logjikës së ndihmës që një familje shqiptare mundet t’i japë fëmijës së vet, deklarin e saktë të këtyre shumave në deklaratat e pasurisë, kohën e krijimit të tyre prej familjes së bashkëshortes, edhe para miratimit të ligjit nr. 9049/2003, e pa të panevojshme analizimin e mëtejshëm të tyre në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë, duke e vlerësuar këtë situatë në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit.

19.6. Në përfundim, nga analiza e kryer, Kolegji vlerëson se shuma prej 320.258 lekësh, për të cilën konfirmohet ekzistenca në sistemin bankar që në vitin 2001, me burim nga dhurimet e prindërve të bashkëshortes, duhet të përfshihet në analizën ekonomike të subjektit.

- 20.** Duke përdorur konkluzionet e arritura në këtë arsytim, që lidhen me: i) fazën e ndërtimit të objektit 1+1 në Sarandë; ii) vlerën e kostos së ndërtimit të tij në shumën prej 1.800.000 lekësh; iii) njohjen si të ligjshme të shumës prej 443.786 lekësh, huazuar nga personi tjetër i lidhur A. M.; iv) njohjen si të ligjshme të shumës prej 1.339.168 lekësh, huazuar nga personi tjetër i lidhur Gj. D.; njohjen si të ligjshme të shumës prej 628.415 lekësh, të krijuar nga kurset private të bashkëshortes; njohjen si të ligjshme të shumës prej 320.258 lekësh, përfutuar nga dhurimet ndaj bashkëshortes para martesës, Kolegji kreu analizën financiare për subjektin e rivlerësimit

³⁸ *Kursi i mesatar i muajit janar 2001, marrë nga arshiva e Bankës së Shqipërisë: 1USD = 141,74 lekë; vlera 1.898 USD x 141,74 = 269.022 lekë.*

³⁹ *Kursi i mesatar i muajit janar 2001 marrë nga arshiva e Bankës së Shqipërisë: 100 drahmi = 39,03 lekë; vlera 200.000 drahmi : 39,03 = 51.236 lekë.*

për vitet 1996-2003 dhe 2003-2004, për të cilat Komisioni kishte konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme.

21. Bazuar në sa më sipër, nga analiza e kryer në Kolegj për vitet 1996-2003, rezulton se subjekti gjendet në kushtet e një balance pozitive për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve deri në këtë vit.
22. Nga kryerja e analizës financiare për vitin 2004, mbi të dhënat e konsideruara sipas konkluzioneve më lart, rezulton se subjekti gjendet në kushtet e një balance negative prej 635.030 lekësh, për krijimin e pasurive dhe shpenzimeve të kryera në këtë vit. Këtë diferencë negative, e cila rezulton nga analiza financiare e këtij viti, Kolegji e vlerësoi në zbatim të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, duke pasur parasysh *së pari*, faktin se ajo rezulton si konsekuencë e mosnjohjes në mënyrë të plotë të shumës së dhënë hua prej personit tjetër të lidhur, z. A. M., në kushtet specifike të rastit të cituara më lart, dhe jo si një produkt i raportit të të ardhurave e shpenzimeve të vetë subjektit të rivlerësimit. *Së dyti*, Kolegji vlerësoi gjithashtu si rrethanë të rëndësishme në përcaktimin e peshës së kësaj balance negative, deklaratimet e sakta e të plota të dhëna nga subjekti për këtë hua, dokumentimin e marrjes së saj dhe të shlyerjes nëpërmjet veprimeve noteriale që në kohën e hershme, si edhe shlyerjen e saj nëpërmjet një kredie të marrë për nevoja të strehimit. Verifikimi i vërtetësisë së deklaratimeve të subjektit, u konsiderua prej Kolegjit si një element që përforcoi besueshmërinë e ekzistencës së marrëdhënies së huas në termat e deklaruar prej subjektit, ndonëse jo të provuar në standardin e aplikuar prej Kolegjit, në zbatim të legjislacionit në fuqi, premisë e cila, konsideruar edhe faktin se mbetet e vetmja balancë negative në të gjithë periudhën e rivlerësimit, krijoi bindjen se subjekti e kapërcen testin e një niveli të besueshëm, për sa i përket vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
23. Lidhur me pretendimet e adresua në ankim, nëpërmjet të cilave subjekti pretendon se Komisioni gjatë shqyrtimit të çështjes së tij të rivlerësimit, ka shkelur parimet e procesit të rregullt ligjor dhe rregullat procedurale të gjykimit, Kolegji e vlerëson të panevojshme të ndalet, për sa kohë konkluzionet e arritura në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë e bëjnë vendimin e Komisionit të cenueshëm, pavarësisht qëndrimit lidhur me shkaqet që adresohen drejt procesit të rregullt. Për më tepër, Kolegj vlerëson se në mënyrë integrale u ka dhënë përgjigje edhe këtyre shkaqeve kur ka analizuar dhe arsyetuar mbi shkaqet që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë.
24. Në përfundim, në vlerësim dhe analizë të konkluzioneve të mësipërme dhe të konkluzioneve të Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës e vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit plotëson në mënyrë kumulative të tria kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në zbatim të kësaj dispozite, duhet të konfirmohet në detyrë. Për sa më lart, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 245, datë 05.03.2020, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit, është marrë në vlerësim jo të saktë të fakteve e provave të administruara gjatë hetimit e në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit dhe, për pasojë, ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 245, datë 05.03.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Ardit Mustafaj dhe konfirmimin e tij në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.09.2022

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, isha kundër ndryshimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 245, datë 05.03.2020, që shkarkoi nga detyra subjektin e rivlerësimit Ardit Mustafaj dhe votova kundër shumicës, e cila ndryshoi vendimin në fjalë dhe konfirmoi subjektin në detyrë. Në vlerësimin tim, vendimi i Komisionit ishte i drejtë dhe duhet të ishte lënë në fuqi pasi subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
2. Isha po ashtu kundër shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike pasi në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ankohej për mungesë njohjeje të akteve në fashikull, që kishte ardhur si rrjedhojë e zgjedhjes së tij personale për të mos u konsultuar me aktet, pavarësisht se ky hap procedural i ishte ofruar dhe mundësuar nga Komisioni. Rezultoi që subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të mos njihej me aktet në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision. Në ankimin në Kolegj, këtë zgjedhje të vullnetshme të subjektit të rivlerësimit, shumica e konvertoi në përgjegjësi dhe lëshim të kryer nga Komisioni. Duke u mbështetur pjesërisht edhe në probleme të fashikullit të përcjellë në Kolegj, të cilat mund të ishin shëruar duke kërkuar të plotësohej fashikulli, shumica e kaloi çështjen në shqyrtim në seancë publike.
3. Vlerësimi im për themelin e shkaqeve të ankimit, siç shtjellohet në vijim, bazohet edhe në konstatimin që, duke kaluar në seancë gjyqësore publike dhe duke pranuar akte të reja në cilësinë e provës, shumica i ka lejuar subjektit të rivlerësimit mundësi shtesë, përtej atyre që parashikon dhe kufizon në mënyrë të shprehur ligji – përkatësisht neni 47, sikurse edhe neni 51 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Në vijim, analiza dhe vlerësimi im për secilin aspekt për të cilin Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh të ligjshme e, për pasojë, me ndikim mbi ligjshmërinë e krijimit të këtyre pasurive. Për qartësi reference, meqenëse vendimi i shumicës nuk referon në pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting* si të tilla, analiza në vijim ndjek strukturën e vendimit të Komisionit. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u bazua në konstatimin e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e një apartamenti në Tiranë, blerë në vitin 2004, një apartamenti në Sarandë, blerë në vitin 2003, dhe një automjeti të blerë në vitin 2004. Pasuritë e tjera të deklaruara e të nënshtruara hetimit administrativ⁴⁰, u gjetën pa problematika nga Komisioni.
 1. *Mungesë burimesh për apartamentin në bulevardin “{***}”, Tiranë⁴¹, në vlerën 58.369 euro në vitin 2004*
5. Së pari, siç shpjegohet më sipër, sjell në vëmendje që në vendimin e shumicës, kjo pasuri nuk identifikohet dhe as referohet në mënyrë të veçantë. Në vendimin objekt ankimi të marrë nga Komisioni, ajo përfaqëson pasurinë me numër 1, të analizuar për burimet e krijimit nga faqja 3 deri në faqen 40. Burimet e krijimit të kësaj pasurie janë deklaruar si vijon: (i) dy kredi [përkatësisht nga Banka Kombëtare Tregtare dhe Raiffeisen Bank]; (ii) të ardhurat familjare nga puna; (iii) të ardhurat nga qiratë; (iv) shitja e një pasurie tjetër në Sarandë në vitin 2004; (v) huaja e shlyer plotësisht [në momentin e hartimit të deklaratës *vetting*]; (vi) të ardhurat nga kurset e bashkëshortes; dhe (vi) dhurata nga të afërmit e kësaj të fundit. Në lidhje me kontrollin e ushtruar për këtë pasuri, kisha vlerësim të ndryshëm nga shumica për sa u përket konkluzioneve që lidhen me mjaftueshmërinë e burimeve të identifikuara më sipër.
6. Nga analiza e kryer në Komision për secilin nga këto burime të deklaruara, u konstatua mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë në Sarandë – në vitin 2003, shitja e së cilës më 28 mars 2004, për 1,8 milionë lekë, ka gjeneruar të ardhura për të shlyer apartamentin e porositur në Tiranë në

⁴⁰ Dy garazhe, automjeti në Tiranë, blerë përkatësisht në vitet 2007 dhe 2014, një automjet blerë në vitin 2013, depozitë kursimi në BKT, në vlerën përreth 2,2 milionë lekë, kursime familjare dhe një truall prej 1000 m² në {***}, Sarandë, blerë në vitin 2003, në pronësi të bashkëshortes.

⁴¹ Apartament 126 m², porositur më 28.07.2004. Shih vendimin e Komisionit, faqet 3—40, në: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/04/Vendim-Ardit-Mustafaj.pdf>.

vitin 2004 – një hua nga vëllai i bashkëshortes së subjektit në vlerën 2 milionë lekë⁴², problematika në lidhje me destinacionin e kredisë lehtësuese, marrë nga banka për strehim, të ardhurat e fituara nga bashkëshortja nga kurset e matematikës në vitet 1997-2004, në vlerën 850 mijë lekë dhe të ardhura nga dhurimet ndaj bashkëshortes, prej familjarëve, në vlerat 200 mijë dhrahmi dhe përreth 1.900 USD⁴³, për të cilat Komisioni vlerësoi se kishte vend për zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Në përfundim, bazuar në analizën financiare të ligjshmërisë së burimeve që kanë shërbyer për shtëpinë në Sarandë [numërtuar “iv” më sipër] në vitin 2003, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në vlerën 2,7 milionë lekë në vitin 2004, për të investuar për apartamentin në Tiranë dhe përballuar shpenzimet e tjera familjare. Në shpenzimet e tjera të periudhës pararendëse, përfshihet një apartament tjetër në Sarandë, blerë në vitin 2003 [shtjelluar edhe më poshtë], në vlerën prej rreth 2,8 milionë lekësh, një truall 1000 m² në {***} (Sarandë) dhe likuiditete në vlerën rreth 1,5 milionë lekë⁴⁴, si dhe një autoveturë në vlerën 530 mijë lekë.

7. Votova ndryshe nga shumica pasi në analizë të akteve në fashikull, vlerësoj të drejtë dhe të bazuar në ligj e fakte konkluzionin e Komisionit për balancën negative sa më sipër, përlllogaritur mbi bazën e çmimeve mesatare të referuara nga EKB-ja për vitet përkatëse. Komisioni vlerësoi se ndërtesa në Sarandë ishte e përfunduar dhe, për pasojë, llogariti vlerën sipas çmimeve mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, që në total për truallin, dy katet mbi tokë nga 120 m² secili, dhe garazhin, arrinin në vlerën prej 5,7 milionë lekësh përafërsisht. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me asnjë dokument që vlera e shpenzuar prej tij për ndërtesën, ishte 1,8 milionë lekë. Komisioni konkludoi se përveçse të paprovuara me dokumentacion, pretendimet e subjektit se ndërtesa ishte në fazën e karabinasë dhe, për pasojë, i kishte kushtuar vetëm 1,8 milionë lekë, binin ndesh me disa akte zyrtare, e konkretisht, me:
 1. aktin e kolaudimit, lëshuar në datën 20.10.2003, hartuar në praninë e vetë subjektit të rivlerësimit, ku referohet se ndërtesa përbëhet nga tri (3) kate, plus garazhi [katër kate], kati i parë *shërben për funksionin lokal*, kati i dytë dhe ai i tretë, secili me sipërfaqe nga 120 m², shërbejnë *për funksionin banesë* respektivisht;
 2. vërtetimin hipotekor të ZVRPP Sarandë, të datës 25.03.2004, sipas të cilit pasuria referuar me 1+1 kate, në emër të subjektit të rivlerësimit, përshkruhet si objekt banesë me “sipërfaqe ndërtimi prej 120 m² dhe sipërfaqe trualli 304 m² që zë”;
 3. kontratën e shitjes së pasurisë nga subjekti më 28.03.2004, në të cilën mungon referenca apo citimi se ndërtesa ishte e papërfunduar;
 4. akte të tjera të gjeneruara nga ZVRPP ndër vite, që dokumentojnë se blerësi ka kryer shtesa anësore dhe katesh deri në pesë (5), ndërsa funksionimi i kateve referohet i njëjtë me atë të përshkruar në aktin e kolaudimit të sipërcituar⁴⁵.
8. Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësova se ishte i drejtë konkluzioni i Komisionit se pretendimi deklarativ i subjektit për një vlerë të reduktuar të shpenzimeve për ndërtim – 1,8 milionë lekë – meqenëse ndërtesa katër- (4-) katëshe ishte në fazën e “karabinasë”, është jobindës. Vlerësimi i burimeve të ligjshme duhet të ishte përlllogaritur bazuar në çmimet e referencës, në kushtet kur gjithë dokumentacioni ligjor i sipërcituar referon një ndërtesë disakatëshe, të përfunduar, për sa kohë hartuesit e dokumentacionit dhe subjekti i rivlerësimit nuk kanë cituar të kundërtën. Vlerësimi i shumicës, bazuar në çmimin e shitjes së apartamentit dhe pretendimet deklarative të subjektit të rivlerësimit, është i gabuar pasi zgjedh të pranojë një version faktesh që bie ndesh me aktet, sidomos me aktin e kolaudimit të hartuar në prani të investitorit, subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që favorizon pozitën financiare të subjektit të rivlerësimit, i cili rezulton të ketë kryer investime të konsiderueshme në periudhën kohore deri në momentin e blerjes së apartamentit në Tiranë, në vitin 2004.
9. Pavarësisht se kontrata e shitjes së ndërtesës disakatëshe në mars 2004, në vlerën 1,8 milionë lekë, ka vlerën e ligjit për palët, sipas normave të së drejtës civile, në kushtet e kontrollit të ligjshmërisë së

⁴² Komisioni rezulton të ketë nisur analizën në faqen 13 të vendimit, në pikën “f”, për vlerën 1 milion lekë, ndërsa në konkluzionin në faqen 19, parashtrohet vlerën 2 milionë lekë.

⁴³ Sipas pyetësorëve. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2003, kjo shumë referohet në vlerën 4 mijë USD dhe përbëhet nga dhurata dhe kursime të bashkëshortes.

⁴⁴ Në total, sipas Komisionit, subjekti rezultoi me një balancë negative prej 6.86.074 lekësh për të gjitha shpenzimet familjare deri në vitin 2003. Për referencë, faqet 30 dhe 38 të vendimit të Komisionit.

⁴⁵ Referuar në faqet 33 dhe 34 të vendimit të Komisionit.

pasurive dhe të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e tyre, nën dritën e parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka të drejtë të çmojë çdo indicie që lidhet me rrethanat e çështjes, sikurse edhe të bazojë vendimin në prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Në këtë tagër, Kolegji duhet të merrte në konsideratë indicie për çmim shitjeje të pavërtetë, nën vlerën e pasurisë, në rastin konkret. Kjo analizë do të ishte e logjikshme edhe nën dritën e aspekteve që lidhen me specifikat e ndërtesës – sipërfaqja në total prej 120 m² x 4 kate – kapacitetet teknike që shoqërojnë ndërtimin e disa kateve në një vend që përballet me lëkundje sizmike si Shqipëria – apo faktin që në periudhën kohore në fjalë, subjekti ka kryer investime të konsiderueshme në pasuri të paluajtshme, ndërkohë që ligji nr. 9049/2003 kishte hyrë në fuqi dhe me të, edhe ndërgjegjësimi i subjekteve për deklarimin e pasurive dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre.

10. Në dritën e këtyre fakteve, pranimi i një vlere ndërtimi prej *1,8 milionë lekësh* për katër (4) kate plus themele, përpos deklarativ, bie ndesh me aktet zyrtare të administruara në fashikull dhe paraqitet i pabazuar, çka është e palogjikshme të pranosh që gjithë veprimet të cilat pasqyrojnë rrethana të pafavorshme për subjektin, t'u atribuohen gabimeve të përfaqësuesit të tij me prokurë, në mënyrë selektive, gabimeve të kolaudatorit apo të ZVRPP-së.
11. Shumica vlerësoi të pranojë se ndërtesa ishte e gjitha në fazën e karabinasë, bazuar në gabime të pasqyrit të kateve në aktin e kolaudimit – ndonëse subjekti nuk rezultoi të ketë pasur kundërshtime për këtë akt – apo në gabime të referuara nga shkresa e ASHK Sarandë, drejtuar subjektit të rivlerësimit⁴⁶ – e që lidhen me veprime të kryera nga ky institucion për ndërtesa të tjera – sikurse edhe me fakte të parashtruara në Kolegj mbi dy vjet pasi ishte marrë vendimi i Komisionit dhe kishte ushtruar ankimin e tij. Këto detaje i konsideroj të rëndësishme për vlerësimin tërësor të besueshmërisë së akteve të sjella prej subjektit në Kolegj dhe pranuar nga shumica e dhënë vlerë provuese vendimtare⁴⁷ përkundër akteve të cituara më sipër në pikat 1-4 të paragrafit nr. 5. Në vlerësimin tim të pasqyruar edhe në vendimin e ndërmjetëm, kam votuar kundër pranimi të tyre në cilësinë e provës, edhe për shkak të distancës kohore, kundrejt ankimit, në të cilën janë sjellë, por edhe sepse motivet e subjektit për këtë mënyrë të vepruarit nuk paraqiten në mirëbesim, siç referoj edhe më tej në këtë arsyetim.

II. Mungesë burimesh për të krijuar pasurinë apartament në Sarandë, më 31 janar 2003, në vlerën 22 mijë USD

12. Pas hetimit administrativ, kryesisht në drejtim të kontrollit të ekzistencës dhe ligjshmërisë së burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni ka konstatuar se subjekti gjendet në pamjaftueshmëri financiare për të justifikuar pagesën e shumës 22 mijë dollarë amerikanë për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003 dhe për të përballuar shpenzimet dhe investimet e tjera në pasuri të paluajtshme të kryera në atë vit⁴⁸. Në vendimin e Komisionit, kjo gjetje pasqyrohet në kontekstin e vitit 2003. Duke abstraguar nga fakti që balanca negative e referuar për këtë pasuri nga Komisioni, është kryer për vitin përkatës⁴⁹ dhe përfshin në përllogaritje edhe pasuritë e tjera të krijuara ose për të cilat janë kryer pagesa deri në vitin 2003, në vlerësimin tim, konstatimi i Komisionit për këtë pasuri, bazuar në mungesën e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. Gj. D. – farefis i shkallës së gjashtë i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit – për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit 1,7 milionë lekë, është i drejtë dhe duhet të ishte lënë në fuqi. Në dritën e kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës së deklaruar të marrë hua, sipas Komisionit.
13. Shumica vendosi të pranojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacionin provues të të ardhurave e, për pasojë, kreu një vlerësim hipotetik të aktivitetit privat të huadhënësit. Vlerësova ndryshe nga shumica pasi aktet në fashikull nuk dëshmojnë pamundësinë objektive, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe pranuar nga shumica, për të gjetur dokumentacionin që provon të ardhurat e huadhënësit. Për rrjedhojë, vlerësoj se përllogaritja hipotetike

⁴⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 23.05.2022, e ASHK Sarandë.

⁴⁷ Paragrafët 14.9 deri në 14.13 të arsyetimit të shumicës.

⁴⁸ Trualli 1000 m² në {***} dhe pasuria nr. 1, shtjelluar më sipër.

⁴⁹ Faqe 47 e vendimit të Komisionit.

e fitimit të akumuluar nga biznesi në pronësi të këtij huadhënësi, kryer nga shumica, është vendim i papabuar në ligj dhe fakte, sikurse edhe krijon hapësirë për arbitraritet.

14. Nga aktet rezulton se biznesi në emër të z. D. dhe detyrimet tatimore rezultojnë të jenë dokumentuar deri në vitin 1998⁵⁰. Po nga aktet, rezulton se shoqëria tregtare në pronësi të këtij individit, ka raportuar çeljen e vitit financiar 2002 – vitin kur pretendohet të jetë marrë huaja – me balancë negative. Edhe përgjigja e, për pasojë, brendia e informacionit të dërguar Komisionit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSh), rezulton të jetë në të njëjtën linjë me atë të dërguar Komisionit nga administrata tatimore. Konkretisht, sipas shkresës së ISSh-së, shoqëria tregtare në pronësi të huadhënësit, ka depozituar listëpagesa për dhjetë muaj në periudhën 1992-1993, tetë muaj me shkëputje në vitin 1995, njëmbëdhjetë muaj në periudhën 1998-1999, dhe gjashtë muaj në vitin 2001⁵¹. Vlerësimi i Komisionit që duke lexuar në harmoni përgjigjen e DRT Sarandë [të sipërcituar] dhe numrin e listëpagesave të depozituara në ISSh, rezulton se dy bizneset në emër të huadhënësit nuk kanë pasur burime të ligjshme për të financuar huan, pasi kanë dëshmuar vështirësi financiare, është i drejtë dhe duhej të lihej në fuqi. Përpos faktit që viti 2002 që përkon me dhënien e huas, ka nisur me balancë negative, Komisionit i ka rezultuar edhe që në periudhën kohore në fjalë, z. D. i është dashur edhe të marrë tri kredi në vitet 2001-2004, në vlerën totale prej 3,1 milionë lekësh nga Fondi Besa.
15. Fakti që në përgjigje të individëve privatë, gjatë procesit të rivlerësimit, administrata tatimore për herë të parë dhe në mënyrë evazive në vitin 2020, pas përgjigjeve me përmbajtje dhe efekt të ndryshëm, referon “transferime të shumta” aktesh që mund të kenë përfshirë edhe ato të cilat i përkasin periudhës relevante – viteve 2002-2003 – por jo viteve të mëhershme, nuk duhet të ishte pranuar nga shumica pasi nuk është bindës logjikisht, përveçse bie haptazi ndesh me kërkesën e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 – cituar më sipër – që institucionet e rivlerësimit të mbështesin vendimin “në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera” dhe “të çmojnë [...] çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”. Nën dritën e akteve të referuara më sipër dhe të fakteve që tregojnë përtej çdo dyshimi që bizneset e z. D. ishin në vështirësi financiare dhe nuk kanë deklaruar të ardhura për efekt të detyrimeve tatimore, sikurse edhe pagesa sigurimesh shoqërore, trupi gjykues duhet të kishte lënë në fuqi vendimin e Komisionit, edhe për këtë aspekt të vlerësimit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Me të njëjtën logjikë, shkresat përcjellë në hetim nga subjekti dhe huadhënësi gjatë hetimit, duhet të ishin vlerësuar pa asnjë kredibilitet, pasi haptazi bien ndesh me korrespondencën mes organeve shtetërore dhe referojnë transferime të cilat hipotetikisht mund të kenë ndodhur apo ndikuar në sasinë dhe llojin e dokumentacionit, që përbëjnë deklarime evazive, të cilat, mbi të gjitha, nuk mund të ngrihen në nivelin e konfirmimit të pamundësisë objektive. Këto akte, të marra në konsideratë, krijojnë precedentë me pasoja serioze në procesin e rivlerësimit.
16. Shumica e bazoi qëndrimin e vet, ndër të tjera, në faktin që subjekti ka deklaruar këtë marrëdhënie huaje në deklaratën periodike vjetore. Pa vendosur në diskutim vlerën e deklarimeve periodike në drejtim të vazhdimësisë dhe përmbushjes së detyrimeve që kanë subjektet deklaruese sipas ligjit nr. 9049/2003⁵² për të kryer një pasqyrim të plotë e të saktë e nën përgjegjësi, të interesave të tyre pasurorë, duke qenë për nga natyra e njëanshme, deklarative, deklarata periodike vjetore nuk mund të provojë se pretendimet e subjektit aty janë katërçipërisht të vërteta. Subjektet deklaruese mbajnë përgjegjësi për deklaratimet e tyre, por deklarata periodike vjetore në vetvete është – siç sugjeron titulli – *deklarative*. Ky element merr rëndësi vendimtare nëse sillet në vëmendje fakti që asnjë nga veprimet e analizuar dhe problematikat e pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk shoqërohen me transferta bankare të të ardhurave apo gjurmë të tjera dokumentare të ndonjërit prej transaksioneve që, në vlerësimin tim, paraqesin probleme. Ekzistenca e veprimeve bankare ose e veprimeve të tjera të dokumentuara, përpos deklarimeve periodike, do të provonin sa është thënë nga subjekti në mënyrë deklarative dhe mund të ndikonte në drejtim të të provuarit të pamundësisë për të ardhurat e ligjshme të munguara të huadhënësit nga aktet zyrtare.

⁵⁰ Shkresa e dërguar Komisionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, datë 09.05.2019, nr. prot. {***}.

⁵¹ Shkresat e ISSh, Dega e Sigurimeve Sarandë, të datës 28.01.2020, me nr. prot. {***} dhe {***}.

⁵² “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

17. Për sa më sipër, vlerësova që subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Po ashtu, sikurse përmendur edhe më sipër, arrita në konkluzionin që veprimet e subjektit të rivlerësimit në formën e mosangazhimit për t'u paraqitur në Komision për t'u njohur me aktet dhe dështimit të gjetjes së një pjese të dokumenteve, të cilat janë sjellë vetëm pas ankimit, përbëjnë hapa të mirëllogaritur në drejtim të krijimit të premisave për të përmirësuar situatën në gjykimin në Kolegj.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi